

# THE KOSOVO BANKER

Zhvillimi i industrisë bankare në Kosovë  
dhe sfidat e mëtutjeshme

Zhvillimi i tregut financiar të  
patundshmërisë në Kosovë

Forumi i sigurisë bankare bashkon bankat  
e Shqipërisë dhe Kosovës në Prizren

## Bankat dhe Ligjet

Zbatimi i ligjit mbetet qështje jetike për institucionet financiare në Kosovë. Kosova ende listohet në vendin 136 nga gjithsejt 189 vende sa i përket zbatimit të kontratave dhe kjo i mohon industrisë bankare instrumentin kryesorë mbi të cilin funksionon sistemi financiar, respektivisht zbatimin e kontratës së nënshkruar me klientin. Sistemi gjyqësor në Kosovë vazhdon të ketë mbi 10,000 lëndë të sistemit financiar të pa përfunduara.





SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

 **Banka Ekonomike**



 **BANKA PËR BIZNES**  
Mundësi për më shumë...

**iŞBANK**

**NLB**  **Prishtina**

 **ProCredit Bank**

 **Raiffeisen  
BANK**

 **TEB**  
BNP PARIBAS JOINT VENTURE



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

**Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK)** është zëri i industrisë bankare në Kosovë. SHBK bashkëpunon me Qeverinë, Bankën

Qendrore të Republikës së Kosovës, mediat dhe opinionin publik, me qëllim të mbështetjes së një industrie të shëndoshë bankare, e cila promovon zhvillimin afatgjatë ekonomik në Kosovë. SHBK lehtëson bashkëpunimin ndërmjet bankave, duke ofruar një platformë të vetme për lobim të përbashkët, si dhe për diskutimin e iniciativave të reja; identifikon dhe influencon iniciativat ligjore dhe rregullative; bashkërendon aktivitete të përbashkëta për bankat, si dhe promovon aktivitetet bankare përpara audiencës së gjerë. Brenda SHBK-së operon Qendra për Trajnime Bankare, e cila ofron trajnime në fushën e bankave dhe të financave.

"The Kosovo Banker" është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Botohet dy herë në vit, me qëllim të informimit të saktë të publikut lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës; Rr. "Bajram Kelmendi", Nr. 15, Prishtinë; 10000, Republika e Kosovës; +381 38 246 171; [www.bankassoc-kos.com](http://www.bankassoc-kos.com); [contact@bankassoc-kos.com](mailto:contact@bankassoc-kos.com);

# THE KOSOVO BANKER

## IMPRESSUM

**BORDI I DREJTORËVE I  
SHOQATËS SË BANKAVE  
TË KOSOVËS**

**Zt. Robert Wright**  
Kryetar i Bordit,  
Raiffeisen Bank Kosovo

**Zt. Ilir I. Aliu**  
Zv. Kryetar i Bordit të Drejtorëve,  
ProCredit Bank

**Zt. Abdurrahman Balkiz**  
Banka Kombëtare Tregtare

**Zt. Albert Lumezi**  
NLB Prishtina

**Zt. Atilla Dağdeviren**  
IS Bank

**Zt. Ayhan Albeyoğlu**  
TEB Bank

**Znj. Merita Gjyshinca Peja**  
Banka Ekonomike

**Zt. Richard Beasley**  
Banka për Biznes

**DREJTOR EKZEKUTIV**  
**Zt. Petrit Balijsa**

**REDAKTORË**

**Znj. Miranda Rugovaj**  
Zyrtare e Administratës dhe  
Komunikimit

**Zt. Kreshnik Kosumi**  
Zyrtar për Politika dhe Statistika

**THE KOSOVO BANKER**  
**MBËSHETETET NGA FONDI EVROPIAN  
PËR EVROPËN JUGLINDORE**



**EUROPEAN FUND FOR SOUTHEAST EUROPE  
DEVELOPMENT FACILITY**

# PËRMBAJTJA

## EDITORIAL 1-2

### SEKTORI FINANCIAR 3-15

- Zhvillimi i industrisë bankare në Kosovë dhe sfidat e mëtutjeshme
- Çfarë e pret industrinë bankare në vitet në vijim?  
Intervistë me z. Robert Wright
- Normat e Interesit në Kosovë, Pjesa 2: A ka hapësirë për ulje, dhe sa?
- Roli dhe rëndësia e funksionit të pajtueshmërisë në Banka
- Forumi i sigurisë bankare bashkon bankat e Shqipërisë dhe Kosovës në Prizren
- Shpëlarja e parave, njëra nga sfidat e sektorit bankar
- Rëndësia e edukimit financiar

### KËNDI I EKSPERTËVE 16-26

- Zhvillimi i Tregut Financiar të Patundshmërisë në Kosovë
- Jo vetëm bankat
- A duhet të implementohet "Bazel II"?

### KOMITETET NË SHBK 27-28

- Rëndësia në adresimin e çështjeve të sektorit bankar përmes Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të vendit

### KËNDI I EDUKIMIT FINANCIAR 29-31

- Terme financiare që duhet ditur
- Një listë verore leximi për bankierët tregtarë

## LAJMET E SHBK-së 32-35

- Java Ndërkombëtare e Parasë në Kosovë
- Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) dhe Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) mbështesin programin e edukimit financiar në Kosovë
- Shqipëria dhe Kosova takohen në Prizren në Forumin për Sigurinë Bankare
- Shoqata e Bankave të Kosovës takohet me misionin e FMN-së
- SHBK merr pjesë në kremtë për nder të Ditës Kombëtare të Republikës së Italisë

## LAJME NGA BANKAT 36-39

- Banka për biznes ndihmon të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës
- BKT në përkrahje të shoqërisë
- Banka TEB vazhdon përkrahjen e tenisit kosovar
- TEB përkrah basketbollistët e së ardhmes
- Banka Raiffeisen donacion në vlerë 100,000 euro për Klinikën Gjinekologjike
- Projektet e përkrahura nga Banka Raiffeisen
- ProCredit Bank pjesë e aksionit "Ta Pastrojme Kosovën"
- ProCredit Bank mbështet gjysmë maratonën ndërkombëtare të Prishtinës 2014



Pikëpamjet e shprehura në shkrimet e revistës janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo politikat e Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) dhe Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE). SHBK dhe EFSE nuk mbajnë përgjegjësi mbi përmbajtjen e artikujve të autorëve të publikuar në revistën "The Kosovo Banker".



## Give your client the full potential of Internet banking

- Whenever/wherever
- Connecting via favourite device (PC, tablet, mobile, SMS)
- Control of finances with Personal Finance Manager
- Simple orders of new services via internet banking
- Integration with social networking
- Interactivity and attractive design

## Optimize your Internet banking services

- Targeted sales of banking services
- Short time to market of new e-banking services
- Paper based operations into paperless activities
- Single Platform for:
  - all e-channels
  - all client types (corporate, SME, individuals)
- Automate your internal work flow
- Support the transparency of cash flow
- Focus on the banking business; use Software as a Service (SaaS)



Halcom d.d., Tržaška cesta 118, 1000 Ljubljana, SLOVENIA/EUROPE

Tel.: + 386 1 200 33 40, Fax: + 386 1 200 33 56,

E-mail: [info@halcom.com](mailto:info@halcom.com), [www.halcom.com](http://www.halcom.com)



# EDITORIAL

**Dr. sc. PETRIT BALIJA**

DREJTOR EKZEKUTIV  
SHOQATA E BANKAVE  
TË KOSOVËS

**Të dashur lexues,**

Kam kënaqësinë e veçantë të ju prezantoj edicionin e pestë të revistës 'The Kosovo Banker'. Kjo revistë është bërë pjesë integrale e informimit sa më gjithëpërfshirës të qytetarëve të Kosovës për sektorin financiar nga Shoqata e Bankave të Kosovës. Kjo reflektohet edhe në entuziazmin e lexuesve të rregullt të revistës që e presin me padurim çdo edicion.

Në këtë numër do të mund të lexoni për shumë zhvillime të reja në sektorin financiar të Republikës së Kosovës me theks të veçantë në ndikimin e infrastruktures ligjore mbi sistemin bankar dhe të informoheni për çështje të ndryshme financiare që kanë të bëjnë me edukimin financiar e që është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e shoqërisë sonë.

Përkundër sfidave që janë evidente në sektorin financiar të Kosovës, industria bankare në Kosovë po zhvillohet në mënyrë mjaft dinamike ku kemi arritur që brenda një periudhe mjaft të shkurtër të kemi 10 institucione

bankare të licencuara në Kosovë. Roli kryesor i bankave të Kosovës mbetet edhe më tutje financimi i sektorëve të rëndësishëm të ekonomisë së Kosovës dhe ekonomive familjare, prandaj bankat kanë një rëndësi të veçantë në procesin e përmbushjes së nevojave ekonomiko-sociale të vendit. Në këtë aspekt, institucionet bankare kanë marrë përsipër riskun në Kosovë duke injektuar mbi 1.8 miliard euro në formë të ndryshme të kredive dhe duke u bërë gardian të mbi 2.4 miliard euro në depozita. Kjo paraqet një nivel të lartë të bashkëpunimit të institucioneve bankare me qytetarët e Kosovës dhe bizneset Kosovare dhe një besueshmëri të lartë në sistemin bankar të Kosovës.

Vetë titulli revistës 'Bankat dhe Ligjet' sugjeron që për institucionet bankare është jetike zbatimi i ligjit. Fatëkeqësisht, Kosova ende listohet në vendin 136 nga gjithsejt 189 vende sa i përket zbatimit të kontratave (raporti i të bërit biznes të Bankës Botërore, 2014).



Kjo i mohon industrisë bankare instrumentin kryesorë mbi të cilin funksionon sistemi financiar, respektivisht zbatimin e kontratës së nënshkruar me klientin. Sistemi gjyqësor vazhdon të ketë mbi 10,000 lëndë të sistemit financiar të pa përfunduara e që paraqet rreth gjysëm miliard euro që nuk janë në funksion të ekonomisë vendore. Ekzistojnë edhe sfida tjera në ekonominë e Kosovës siç është deficieti tregtarë i Kosovës i cili mbetet një sfidë e pamohueshme dhe deri më tani e papërmirësuar në nivel të duhur. Kjo paraqet një sfidë serioze makroekonomike e cila mund të përmirësohet vetëm përmes një strategjie nacionale për zhvillimin ekonomik dhe mbështetjen e sektorëve strategjik përfshirë këtu edhe mbështetjen për institucionet financiare në mënyrë që të kenë një afarizëm me risk më të ultë.

Në këtë kontekst, në këtë edicion të revistës janë identifikuar shumë prej barrierave të cilat paraqesin vështirësi për një zhvillim të qëndrueshëm si të institucioneve bankare ashtu edhe bizneseve dhe ekonomive familiare. Prandaj mbetet prioritet edhe më tutje që të punohet së bashku duke koordinuar angazhimet e institucioneve bankare, institucioneve tjera shtetërore, por edhe qytetarëve të Kosovës në përmirësimin e mjedisit e të bërit biznes. Kjo do të mundësonte që bankat të zhvillojnë një afarizëm të qëndrueshëm dhe njëkohësisht bizneset të zgjerojnë veprimtaritë e tyre duke krijuar vende të reja të punës dhe duke ju mundësuar qytetarëve që të financojnë objektivat e tyre për një jetë më të mirë.

Sinqerisht,  
*Petrit Balijs*

# Zhvillimi i industrisë bankare në Kosovë dhe sfidat e mëtutjeshme

Rëndësia që ka industria bankare për zhvillimin dhe stabilitetin e çdo ekonomie u konfirmua edhe një herë nga kriza e fundit globale. Ishin pikërisht zhvillimet në sektorin bankar të cilat me shpejtësi u përhapën në pjesët tjera të sistemit financiar duke shkaktuar krizë financiare, e cila pastaj u shndërrua në krizë të përgjithshme ekonomike. Ndikimi i krizës globale në Kosovë ishte mjaft i kufizuar, gjë që në masë të madhe i atribuohet edhe fundamenteve të shëndosha mbi të cilat është ndërtuar dhe zhvilluar sektori bankar i Kosovës.

Për dallim nga vendet tjera të rajonit, të cilat u deshën të ndjekin një proces të gjatë e të vështirë të tranzicionit të sektorit bankar nga sistemi i ekonomisë së centralizuar drejtë ekonomisë së tregut, Kosova u gjend në një situatë më ndryshe duke mos trashëguar asgjë nga sistemi financiar i kaluar. Në njërin anë, kjo paraqiste një disavantazh të theksuar me që gjithëçka rreth funksionalizimit të sektorit bankar dhe financiar në përgjithësi duhej të nisej nga e para, gjë që paraqiste një proces mjaft sfidues. Në anën tjetër, e gjithë kjo ka paraqitur një përparësi me që u mundësua krijimi i një sistemi financiar i cili që nga fillimi u bazua në parimet e ekonomisë së tregut dhe evitoi problemet me të cilat u ballafaquan shtetet tjera. Në këtë kontekst, Kosova që nga fillimi u përcaktua për një sektor bankar të bazuar në pronësinë private dhe i hapi dyert hyrjes së bankave të huaja, të cilat, përveç kapitalit, sollën edhe praktikat bashkëkohore të

**Z. BEDRI HAMZA**  
 GVERNATOR  
 BANKA  
 QENDRORE E  
 REPUBLIKËS  
 SË KOSOVËS



afarizmit bankar, duke mundësuar kështu një konvergjim më të shpejtë të industrisë bankare të Kosovës drejtë atyre të vendeve me përvojë më të gjatë në këtë fushë.

Zhvillimi i sektorit bankar të Kosovës gjatë këtyre 15 viteve me të drejtë është konsideruar si "tregim i suksesshëm". Gjatë kësaj periudhe, sektori bankar ka shërbyer si burim shumë i rëndësishëm i financimit për ekonominë e vendit. Të dhënat e fundit tregojnë se vlera e gjithsej kredive të sektorit bankar ka arritur në rreth 1.84 miliard euro që paraqet rreth 35 përqind të produktit të brendshëm bruto. Gjatë kësaj kohe, bankat me ritëm të shpejtë kanë bërë zgjerimin e infrastrukturës bankare në gjithë territorin e Kosovës, duke lehtësuar kështu qasjen e individëve dhe bizneseve në shërbimet bankare. Sot, përveç zonave urbane, qytetarët kanë qasje në degët bankare edhe në disa nga zonat më të mëdha rurale. Përhapje të shpejtë ka shënuar edhe pjesa tjetër e infrastrukturës fizike të bankave, siç janë bankomatët, pikat e shitjes, etj.

Zgjerimi i shpejtë i infrastrukturës fizike, së bashku me rritjen e gamës së produkteve dhe zvogëlimin e normës së margjinës së interesit paraqesin segmentet kryesore në të cilat është zhvilluar konkurrenca e sektorit bankar të Kosovës.

Normat e interesit në kredi, përkundër se ende vlerësohen të jenë të larta, kanë shënuar rënie të vazhdueshme në vitet e fundit. Në prill 2014, norma mesatare e interesit në kredi ishte 10.7 përqind, krahasuar me normat që silleshin në rreth 14 përqind deri para pak kohe.

Përkundër se është sektori më i ri bankar në gjithë rajonin, sektori bankar i Kosovës ka një karakteristikë të veçantë dalluese, e që është niveli i lartë i stabilitetit që e ka karakterizuar prej fillimit të funksionimit të tij e që vazhdon edhe tani. Ky sektor në vazhdimësi ka gëzuar pozitë të kënaqëshme likuiditeti, cilësi të mirë të portofolit kreditor si dhe nivel të lartë të kapitalizimit. Kosova paraqet vendin e vetëm në rajon me normë të kredive joperformues nën 10 përqind (8.6 përqind në mars 2014), përderisa treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në vazhdimësi ka qëndruar në rreth 17 përqind (17.4 përqind në mars 2014). Kjo ka bërë që edhe në periudhën e krizës globale, kur për shumë vende sektori bankar ishte bërë kërcënim serioz

---

**Përkundër se është sektori më i ri bankar në gjithë rajonin, sektori bankar i Kosovës ka një karakteristikë të veçantë dalluese, e që është niveli i lartë i stabilitetit që e ka karakterizuar prej fillimit të funksionimit të tij e që vazhdon edhe tani.**

---

ose edhe barrë e rëndë e financave publike dhe ekonomisë në përgjithësi, në Kosovë ky sektor ishte në gjendje të jep kontribut të rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik.

Rol të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit bankar dhe ruajtjen e stabilitetit të tij kishte edhe Banka Qendrore, e cila zhvilloi një kornizë rregullative të bazuar në praktikën bashkëkohore dhe poashtu siguroi implementimin adekuat të kësaj kornize rregullative, duke bërë që sjellja e bankave të jetë në përputhje me parimet e bankikut të shëndoshë. Kujdes i veçantë i'u kushtua politikës së licencimit të bazuar në parimet e licencimit të shëndoshë, çka paraqet një ndër parakushtet më të rëndësishme për

zhvillimin dhe stabilitetin e sektorit bankar. Në këtë kontekst, një ndër aktivitetet e rëndësishme të Bankës Qendrore është promovimi i vazhdueshëm i ambientit financiar e ekonomik te investitorët e rinjë, duke synuar kështu nxitjen e konkurrencës së shëndoshë në sistemin bankar. Poashtu, vëmendje e veçantë i'u kushtua zhvillimit të infrastrukturës bankare, duke përfshirë sistemin e pagesave, regjistrin e kredive, si dhe skemat tjera të cilat kanë lehtësuar afarizimin e bankave.

Me gjithë arritjet e deritanishme, sektorin bankar të Kosovës e presin sfida të mëtutjeshme për të avancuar rolin e tij në përkrahjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Përkundër rritjes së vazhdueshme të kreditimit, raporti ndërmjet kredive dhe produktit të brendshëm bruto në Kosovë vazhdon të jetë më i ulët krahasuar me vendet tjera, duke sugjeruar kështu se ka hapësirë për zgjerim të mëtutjeshëm të ndërmjetësisimit financiar. Kreditimi i deritanishëm ka qenë kryesisht i koncentruar në sektorin e tregtisë, mirëpo kërkohet një zgjerim më i shpejtë i kreditimit edhe për sektorët tjerë, siç janë prodhimtaria e bujqësia, sektorë këta që kanë rëndësi të madhe për përshpejtimin e zhvillimit ekonomik të vendit. Rritja e kreditimit për këta sektorë pa dyshim se varet edhe nga vetë zhvillimi i këtyre sektorëve, por një parakusht shumë i rëndësishëm për zhvillimin e tyre është pikërisht financimi. Në këtë kontekst, bankat duhet të ndjejnë përgjegjësinë për të rritur përkrahjen ndaj sektorëve më pak të zhvilluar të ekonomisë, gjë e cila do të ndikojë edhe në rritjen e tregut për vetë bankat si dhe do të përmirësojë ambientin e përgjithshëm ku ato operojnë. Në këtë aspekt, mes tjerash, bankat mund të japin kontribut të rëndësishëm përmes aktiviteteve të ndryshme të edukimit dhe trajnimit, duke ndihmuar përgatitjen e këtyre sektorëve në përmbushjen e kriterëve të kërkuara nga bankat për kreditim.

Në vitet e fundit, kreditimi nga sektori bankar është karakterizuar me ngadalësim të vazhdueshëm të normës së rritjes, përderisa depozitat kanë vazhduar të rriten me trend mjaft të qëndrueshëm. Kjo tregon se kemi të bëjmë me tërheqje të likuiditetit nga ekonomia, gjë e cila mund të ndikojë në ngadalësimin e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik. Andaj, bankat duhet të reflektojnë me kujdes ndaj këtyre zhvillimeve, duke marrë masa që sigurojnë kreditim të qëndrueshëm për ekonominë e vendit dhe rritje të kërkesës.



Kreditimi i qëndrueshëm i ekonomisë pa dyshim se kërkon edhe kushte më të favorshme për kredimarrësit, përmes së cilave stimulohet kërkesa për kredi dhe nxitet aktiviteti i përgjithshëm ekonomik. Andaj, përkundër rënies së deritanishme të normave të interesit, mbetet sfida zvogëlimi i mëtutjeshëm i tyre. Duke ditur se pjesa më e madhe e shpenzimeve të bankave përbëhet nga shpenzimet operacionale, atëherë zvogëlimi i normave të interesit kërkon rritje të efikasitetit operacional të bankave. Rritja e efikasitetit të bankave tani më mund të vlerësohet se është një proces më i lehtë, duke pasur parasysh se bankat kanë arritur një nivel të kënaqshëm të konsolidimit të infrastrukturës dhe të profesionalizmit të personelit të tyre.

Sidoqoftë, rritja e efikasitetit operacional të bankave është proces kompleks dhe, përveç faktorëve nën kontrollin e bankave, ndikohet edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm. Për shembull, joefikasiteti i mjaftueshëm i sistemit gjyqësor në Kosovë pasqyrohet drejtëpërsëdrejti edhe në efikasitetin e sektorit bankar. Në këtë rast, vlen të theksohet angazhimi intenziv që po bëjmë në nxitjen e reformës në sistemin gjyqësor, duke inkurajuar krijimin e dhomave të veçanta për trajtimin e lëndëve të lidhura me bankat. Faktorë të tjerë të rëndësishëm që ndikojnë në nivelin e normës së interesit në kredi janë edhe faktorët e lidhur me bizneset, siç janë dobësitë në cilësinë e raportimit financiar dhe kapacitetet e bizneseve

për të bërë planifikim adekuat të afarizmit të tyre. Të gjitha këto paraqesin shpenzime shtesë të bankave për të bërë vlerësimin adekuat të aplikacioneve për kredi. Për më tepër, duke ditur se afarizimi bankar është biznes mjaft i ndjeshëm dhe bankat duhet të kenë në konsideratë të gjithë faktorët që mund të ndikojnë në stabilitetin e tyre, atëherë kuptohet se problemet e lartëcekura ndikojnë në rritjen e nivelit të perceptuar të rrezikut nga bankat, gjë e cila pastaj reflektohet edhe në lartësinë e normës së interesit.

Për të përfunduar, dëshiroj të ritheksoj rolin e rëndësishëm të sektorit bankar për zhvillimin dhe stabilitetin e ekonomisë së vendit që nga fillimi i funksionimit të tij dhe perspektivën e favorshme zhvillimore të këtij sektori. Megjithatë, siç e thash edhe më lartë, këtë sektor e presin sfida të mëtutjeshme në zhvillimin e mëtejshëm, por të cilat duhet adresuar bashkërisht nga të gjithë aktet në ekonominë e vendit. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar për të siguruar stabilitetin financiar, por edhe për nxitjen dhe përkrahjen e zhvillimit të mëtejshëm të këtij sektori. Duke ditur rëndësinë e sektorit bankar për qytetarët dhe ekonominë në përgjithësi, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të vazhdojë së trajtuar me prioritet të lartë komunikimin e rregullt me publikun qoftë përmes mediave ashtu edhe përmes publikimit të statistikave dhe raporteve të tjera analitike.



# Çfarë e pret industrinë bankare në vitet në vijim?

## Intervistë me Z. Robert Wright

**SHBK: Cili është mendimi juaj në lidhje me zhvillimin e përgjithshëm të industrisë bankare në Kosovë gjatë 10 viteve të fundit? A jeni të kënaqur me dinamikën e këtij zhvillimi?**

**z. Wright:** Unë mendoj se industria bankare e Kosovës duhet të jetë shumë krenare për zhvillimin gjatë 10 viteve të fundit dhe të gjithë treguesit tanë kyç të performancës janë shumë të favorshëm krahasuar me të gjithë sektorët tjerë bankar në rajon. Numri i bankave të huaja në treg dhe ardhja e fundit e dy bankave të reja gjithashtu tregon se tregu është shumë tërheqës. Me kredi dhe depozita në nivele rekord, besoj se mund të themi se edhe kënaqësia e konsumatorit është gjithashtu në nivel shumë të mirë. Ne kemi bërë një rrugë të gjatë gjatë këtyre 10 vjetëve dhe industria bankare në Kosovë tani ofron produkte dhe shërbime si edhe çdo vend tjetër European.

**SHBK: Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballlet industria bankare në Kosovë?**

**z. Wright:** Biznesi ynë ka të bëjë kryesisht me menaxhimin e rrezikut dhe si gjithmonë, kjo është sfida më e madhe për industrinë. Rreziku mund të vijë në shumë forma dhe kjo nuk ka të bëjë vetëm me rrezikun e kredisë. Ka edhe rreziqe operationale, rreziqe likuiditeti, dhe rreziqe tregu. Unë mendoj se ne mund të themi se rreziqet e likuiditetit janë minimale në këtë moment, por ka ende sfida të menaxhimit të likuiditetit të tepërt që është aktualisht në banka. Megjithatë, sfida më e madhe e rrezikut është padyshim rreziku i kredisë pasi që ka shumë ndikime, disa brenda kontrollit tonë në Kosovë dhe disa jashtë kontrollit tonë, nga jashtë, të tilla si ndryshimet makro-ekonomike në vendet mëmë të bankave të huaja ose efekti i krizave gjeopolitike si në Ukrainë dhe Rusi.

### Z. ROBERT WRIGHT

KRYETAR I BORDIT  
TË SHBK

DREJTOR  
EKZEKUTIV I  
RAIFFEISEN BANK  
NË KOSOVË



Përveç menaxhimit të rrezikut unë mendoj se industria bankare në Kosovë po ashtu përballlet me sfida në fusha të tilla si efikasiteti dhe besueshmëria e sistemit ligjor, nevoja për të përmirësuar njohuritë financiare të klientëve të bankës dhe zhvillimi i financimit të banimit për të krijuar një popullsi që kanë shtëpitë e tyre në të gjithë vendin.

**SHBK: Çfarë mendoni në lidhje me zhvillimin e industrisë bankare në Kosovë në krahasim me rajonin?**

**z. Wright:** Siç thashë më parë, Kosova krahasohet shumë favorshëm me rajonin në shumë Indikatorë Kyç të Performancës (IPK). Gjithashtu mendoj se Kosova është përafëruar me rajonin në fusha të tilla si përdorimi elektronik bankar dhe reduktimi i transaksioneve në para të gatshme pasi që profili i ri demografik i vendit ka qenë i përkryer për miratimin e hershëm dhe entuziast të proceseve bankare elektronike, jashtë degëve fizike.

Unë gjithashtu mendoj se janë tre faktorë kryesorë që na mundësojnë arritjen e IPK-ve mbresëlënëse dhe shumë të favorshme krahasuar me rajonin. Ato janë mungesa e ekspozimit ndaj riskut të kreditimit në valutë të huaj,

volumin tonë të lartë të likuiditetit me kosto të ulët, dhe fitimin tonë. Këto janë tre kriteret që mbështesin çdo industri të suksesshme bankare.

### **SHBK: Cilat janë mundësitë kryesore që industria bankare në Kosovë të përparoj?**

**z.Wright:** Financimi i banimit është padyshim një mundësi e madhe. Sot brezi i ri dhe profesional që marrin rrogë duan të zotërojnë prona të tyre dhe të gëzojnë të gjitha përfitimet dhe faktorin e 'rehatisë' të asociuar me pronësinë e një pasurie me vlerë në rritje. Prona gjithashtu siguron një kolateral për hua pa rrezik dhe me normë të ulët interesi. Financimi i strehimit do të sigurojë rrjedhjen e parave të gatshme shumë të nevojshme në industrinë e ndërimit dhe në zinxhirin e tij të furnizimit, si dhe gjenerimin e biznesit për të gjithë furnizuesit e pajisjeve shtëpiake që blerësit e pronës blejnë sapo të jenë rilokuar.

Unë gjithashtu mendoj se ka ende mundësi të konsiderueshme për bankat në fusha të tilla si bankimi elektronik dhe digjital. Përveç sigurimit 24 orë bankim të përshtatshëm për të gjithë klientët tanë, këto shërbime bankare gjithashtu zvogëlojnë shpenzimet tona operative dhe kanë një efekt pozitiv mbi çmimet tona të kredive dhe depozitave.

Mundësi tjera të rëndësishme për industrinë bankare mund të maksimizohen në të ardhmen, nëse shohim zhvillime në fusha të tilla si industri të reja me avantazhe konkurruese të qarta rajonale, të gjithë punonjësit e sektorit privat të kenë pagat e tyre të paguara përmes bankave dhe legjislacionit primar dhe sekondar bankar të jetë në linjë me praktikën më të mira të BE-së.

### **SHBK: Si e shihni kërkesën dhe ofertën aktuale për kredi në Kosovë?**

**z.Wright:** Vëllimi i portofolios së kredive dhe depozitave në sektorin bankar të Kosovës janë në pikën më të lartë të rritjes dhe sigurisht nuk ka asnjë problem me furnizimin e fondeve për kredi. Ka likuiditet të tepërt në treg dhe kjo është menjëherë në dispozicion për kreditim. Kërkesa për kredi ndryshon në mes të individëve dhe sektorëve të biznesit dhe është e ndikuar nga një numër faktorësh të tillë si sezonaliteti, kushtet makro ekonomike, ngjarjet politike të tilla si zgjedhjet e fundit, dhe faktorë më subjektiv dhe irracional të tillë si optimizmi dhe ndjenjat.

Unë me këtë rast do të doja të hedh poshtë mitin dhe keqkuptimin e krijuar se bankat kontrollojnë furnizimin e kredive rregullisht dhe në mënyrë dramatike. Unë mund t'ju siguroj se furnizimi i kredive është i vazhdueshëm, mirëpo kërkesa është shumë më e ndryshueshme.

### **SHBK: Si do të ju përgjigjeshit kritikave drejtuar sektorit bankar se i keni normat më të larta të interesit në rajon?**

**z.Wright:** Nuk e mohoj se normat e kredisë janë relativisht të larta krahasuar me rajonin, por norma mesatare e interesit të cilës i referohemi përfshin një gamë të gjerë të faktorëve dhe ndikimeve që nuk e bëjnë krahasimin mes shteteve aq të thjeshtë sa mund të duket fillimisht. Kjo çështje ka nevojë për një intervistë të tërë në vete prandaj nuk do të hyj në detaje tani. Megjithatë, unë mund të them se norma mesatare e kredisë në Kosovë vazhdon të zvogëlohet dhe në Prill 2014 ishte 10.4%. Që mesatarja të jetë 10.4% do të thotë që në treg duhet të ketë norma të interesit të ulta si 7 apo 8%.

Unë e kam thënë shumë herë se konsumatorët kanë një ndikim të rëndësishëm në normat e interesit që ofrohen, veçanërisht konsumatorët e biznesit. Normat e interesit përcaktohen kryesisht nga risku që bankat janë duke marrë. Nëse një klient biznesi ka një plan të mirë biznesi me avantazhe të qarta konkurruese dhe të qëndrueshme të mbështetura nga pasqyra të audituara financiare dhe kolateral të mirë atëherë normat e interesit mund të jenë rreth 8 apo 9%. Nëse asnjë nga këta faktorë nuk janë në vend atëherë norma e interesit mund të jetë 14 ose 15%.

Një pikë tjetër për t'u marrë parasysh është se portofolio e kredive të sektorit bankar është në pikën më të lartë që ka qenë ndonjëherë duke sugjeruar se konsumatorët janë relativisht të kënaqur me normat e interesit. Hulumtimet tona tregojnë se norma e interesit nuk është asnjëherë i vetmi faktor që mirret në konsideratë kur klienti zgjedh një bankë. Reputacioni, shërbimet dhe menaxhimi i marrëdhënieve janë faktorë të tjerë kyç.

### **SHBK: A është tregu bankar i Kosovës i prekur nga Banka Qëndrore Evropiane dhe uljet e normave që aplikon kjo bankë?**

**z.Wright:** Jo është përgjigja e thjeshtë. Ne jemi relativisht imun nga kjo, për shembull ne kemi

një vëllim të vogël të kredive apo depozitave të lidhura me margjinën e EURIBOR.

**SHBK: A mendoni se komuniteti i biznesit në Kosovë është duke përjetuar vështirësi dhe a paraqet kjo ndonjë kërcënim për industrinë bankare?**

**z.Wright:** Kjo është një pyetje shumë e gjerë dhe vështirësitë ndryshojnë për nga industria dhe rajoni. Kur vështirësitë ekzistojnë atëherë ato natyrisht krijojnë një kërcënim për sektorin bankar. Siç e përmenda më parë, biznesi jonë kryesisht ka të bëjë me menaxhimin e riskut dhe të qenit në gjendje të parashikojmë vështirësitë, identifikojmë shenjat paralajmëruese të hershme dhe të veprojmë në mënyrë parandaluese për zvogëlimin e riskut për të minimizuar efektin e tij. Kjo është arsyeja pse është shumë e rëndësishme për bankat që të kenë marrëdhënie shumë të mira të punës me klientët e tyre dhe një shkëmbim të mirë dhe efektiv të njohurive dhe këshillave.

**SHBK: A ka informaliteti efekt negativ në industrinë bankare?**

**z.Wright:** Po, ka. Informaliteti rrit riskun e kreditimit për bankat dhe është shpesh shkak-tari për kredi të këqija.

Megjithatë unë mendoj se efekti i informalitetit është edhe më i madh për bizneset. Gjithnjë e më tepër sektori bankar është hezitues të jep hua për sektorin informal kështu që kjo i pengon bizneset të marrin kredi dhe të zhvillojnë bizneset e tyre, ose janë të detyruar të përdorin huadhënës të palicencuar me të gjitha kostot dhe vështirësitë që lidhen me ta. Përfitimet reale apo të perceptuara të të vepruarit joformalisht janë më shumë se të kompenzuara nga paaftësia për të maksimizuar mundësitë që vijnë nga një marrëdhënie dinamike dhe transparente me një bankë.

**SHBK: A mendoni se institucionet e Kosovës kanë bërë mjaft për të njohur dhe shpërblyer kontributin që bankat ndërkombëtare kanë bërë në aspektin e investimeve të huaja?**

**z. Wright:** Unë mendoj se kontributi ynë për mirëqenien dhe zhvillimin e ekonomisë së Kosovës gjatë dekadës së fundit është ndonjëherë i nënvlerësuar dhe jo plotësisht i çmuar.

Përveç miliarda eurove që ne kemi injektuar në ekonominë e Kosovës ne gjithashtu kemi pasur një efekt shumë pozitiv përgjatë gjithë zinxhirit të furnizimit të sektorëve të shumtë të biznesit, krijimit të punësimit, pasurisë dhe prosperitetit në të gjithë vendin.

Unë gjithashtu mendoj se ndonjëherë ne marrim kritika të padrejta në lidhje me obsesionin tonë të perceptuar me profitabilitetin tonë përfundimtar. Për shembull, disa banka kanë degë dhe bankomatë me humbje në zonat rurale të Kosovës, por këto mbahen për arsye të mirëqenies sociale, për të mundësuar komunitetet e largëta të kenë qasje në shërbime bankare. Sektori bankar gjithashtu kontribon përmes sponsorizimeve dhe mbështetjen e shumë projekteve, ngjarjeve dhe iniciativave në fusha të tilla si shëndetësia, arsimi, sporti dhe mirëqenia sociale. Ne të gjithë e vlerësojmë plotësisht dhe në mënyrë aktive demonstrojmë se ne duhet t'i kthejmë diçka komunitetit të biznesit dhe individëve që kontribuojnë në suksesin tonë.

**SHBK: Cilat janë disa nga rekomandimet tuaja për institucionet e Kosovës me qëllim të përmirësimit të të bërit biznes në Kosovë?**

**z.Wright:** Kam 5 rekomandime kryesore më poshtë:

- Përmirësimi i transparencës përmes zhvillimit të rregullatorëve dhe kodit të mirësjelljes në fusha të tilla si nevoja për raporte financiare vjetore të audituara, mungesa e tolerancës së evazionit fiskal dhe pagesa e pagave të të punësuarve përmes bankave;
- Krijimi i një mjedisi sipërmarrës të biznesit që nxit kreativitetin dhe inovacionin dhe ku produktet dhe shërbimet e reja mund të zhvillohen;
- Rregullimi dhe limitimi i industrive të ngopura ku ka tashmë shumë akterë dhe avantazhi i vetëm që ata kanë është një çmim më i ulët. Kjo nuk është e qëndrueshme;
- Përmirësimi i mjedisit rregullator për zgjidhjen e kredive të këqija dhe çështje të tjera ligjore që kanë të bëjnë me bizneset;
- Kudo që është e mundur, të miratohen praktikat më të mira primare dhe sekondare të BE-së dhe të mos krijohen legjislacione të lokalizuara që shkaktojnë vonesa, paqartësi dhe konfuzion në dëm të bizneseve dhe ekonomisë së Kosovës;

**Borxhi është detyrimi i njërit, pasuria e tjetrit.**

**(Paul Krugman)**

# Normat e Interesit në Kosovë, A ka hapësirë për ulje, dhe sa?

**Pjesa e dytë**

Në artikullin e kaluar, të publikuar në numrin e 4-të të revistes "The Kosovo Banker", argumentova se arsyet për normat e larta të interesit nuk janë kritikën e zakonshme komerciale që sidomos kohëve të fundit ia drejtojnë gishtin vetëm bankave, por një gjendje e tillë vazhdon të mbretëron për shkak të situatës së brishtë ekonomike, juridike e sociale në vend, përgjegjësi e cila i bie Qeverisë së Kosovës si rol primar. Megjithatë, në këtë artikull do argumentojmë se a ka hapësirë që bankat megjithatë ti ulin normat e interesit edhe në këto kushte aktuale. Edhe pse deri tash shpesh kemi dëgjuar shifra paushalle pa ndonjë mbështetje të logjikshme numerike, më lejoni të ju argumentoj se sa e vogël është kjo hapësirë, dhe si mund të ulen konkretisht ato.

Kur flasim për norma të interesit në kredi, një model më i thjeshtuar tregon se:

**Normat e Interesit në kredi apo të hyrat nga interesi = Shpenzimet e Interesit (Depozitat dhe Huazimet) + Rreziku (Provizionet apo humbjet nga kreditë e këqija) + Shpenzimet Operative (Pagat dhe shpenzimet tjera) + Net Profiti.**

Pra, në qoftë se bankat heqin dorë nga profiti, ato prap duhet ti paguajnë depozitarët e vet, duhet ti llogarisin humbjet nga kreditë e këqija (provizionet), dhe duhet ti paguajnë punëtorët dhe shpenzimet e tjera të saj. Sidoqoftë, duke marrë parasysh që bankat kanë edhe të hyra të tjera (kryesisht nga tarifat dhe komisionet), ne e përdorim modelin e njëjtë, vetëm se në anën e majtë të ekuacionit marrim parasysh total të hyrat e bankës. Pas transformimit në numra, ky model do dukej si në vijim:

**220.5 milion Euro total të hyra për vit = 54.4 milion shpenzime të interesit (depozita dhe huazime) + 34 milion Euro Provizione apo humbje nga kreditë e këqija + 97.8 milion Euro shpenzime operative + 34.4 milion Euro Profit.**



**EDON XHARRA**

ANALIST I RISKUT  
PËR KORPORATA

RAIFFEISEN  
BANK KOSOVA

Pra, me një normë efektive mesatare të interesit prej 14.2% në 5 vitet e fundit (duke i përfshirë të gjitha shpenzimet), sistemi bankar në Kosovë ka pasur të hyra nga interesi prej 178.2 milion Euro, ku pasi që ia shtojmë edhe të hyrat e tjera prej 42.4 milion Euro, në total i bie 220.5 milion Euro. Nga këto të hyra, 186 milion Euro janë paguar të gjitha shpenzimet, prej të cilave 54.4 milion euro janë shpenzuar për ti paguar kryesisht depozitarët, 34 milion euro janë shpenzuar në humbje nga kreditë e këqija apo provizionet, dhe 97.8 milion Euro janë shpenzuar në paga dhe shpenzime të tjera operative, gjë e cila ka rezultuar me 34.4 milion Euro profit.

Tani përderisa i kemi shifrat në dispozicion, mund të analizojmë se sa është pika maksimale që sistemi bankar mund ta ulë normën e interesit pa kaluar në humbje, e që në ekonomi quhet si pika kritike e rentabilitetit, apo anglisht e njohur si break even point. Në qoftë se të hyrat nga 14.2% interes kanë qenë 178 milion Euro (14.2% \* 1.25 miliardë Euro kredi mesatare në treg), atëherë një zbritje prej 2.7 pikë përqindje, apo një rënie e normës së interesit në 11.5% do të ishte norma më e vogël e interesit ku sistemi bankar do operonte pa humbje dhe pa fitim (shiqoni tabelën e mëposhtme të analizës së ndjeshmërisë). Në një skenario të tillë, të hyrat nga interesi do ishin 144 milion Euro, ku pasi që ia shtojmë edhe të hyrat e tjera prej 42 milion Euro, do rezultonte në

total të hyra prej 186 milion Euro. Duke kujtuar se edhe shpenzimet e sistemit bankar ishin 186 milion Euro, kjo i bie se me 11.5% normë efektive të interesit, sistemi bankar do operonte pa profit.

Kjo dëshmon se deklaratat e disa analistëve (e që fatkeqësisht aty bëjnë pjesë edhe shumë ekonomist) se normat e interesit duhet të ulen në 6%, 8% apo 10% janë të gabuara dhe paushalle. Me 6% normë interesi, sistemi bankar do të humbiste 68 milion Euro, me 8% do humbiste 43 milion Euro, dhe me 10% do humbiste 18 milion Euro. Një situatë e tillë vetëm se do i detyronte bankat ti mbyllin dyert e tyre dhe ti largojnë nga puna 3,700 punëtor, duke e rënduar edhe më tepër ekonominë kosovare.

## Si të ulen normat e interesit?

**Shpenzimet Operative** – Më lartë dokumentuam se këto janë shpenzimet më të larta nga të gjithë variablat në ekuacion, dhe zvogëlimi i tyre është shumë i rëndësishëm për krijimin e mundësisë për uljen e normave të interesit. Peshë më të madhe në rënie e tyre do të kishte ndryshimi i politikave fiskale nga Qeveria e Kosovës, kryesisht përmes koncentrimit të shpenzimeve qeveritare në projekte që do ndikojnë në rritje signifikante të ekonomisë, ndryshe nga shpenzimet aktuale që kryesisht janë vetëm në infrastrukturë dhe që nuk gjenerojnë rritje të qëndrueshme ekonomike. Rritja e ekonomisë në Kosovë do ndikonte në rritjen e kreditimit në vend, e që si rezultat do krijonte ekonomi të shkallës dhe rënie të shpenzimeve operative fikse, duke krijuar mundësi për uljen e normave të interesit.

**Shpenzimet e Interesit** – Këto përbëjnë shpenzimin e dytë më të lartë në ekuacion. Duke marrë parasysh që Kosova nuk ka valutë të saj dhe nuk mund të printoj para, dhe duke marrë parasysh që Kosova nuk është anëtare e Bankës Qen-

drore Evropiane për të pasur qasje në burime më të lira të financimit, kjo është çështje më tepër e ekonomisë së lirë të tregut, pasi që vet bankat kanë synim që maksimalisht ti ulin shpenzimet e interesit për ta rritur profitin e tyre.

**Provizionet e larta** - Këto përbëjnë shpenzimin e tretë më të lartë në ekuacion. Vetëm në vitin 2012, provizionet shtesë kanë qenë 16 milion Euro, gjë që është mjaftë shqetësuese pasi që të hyrat nga interesi janë rritur vetëm 5 milion, dhe në qoftë se vazhdon një trend i tillë, sistemi bankar do përjeton ngritje të normave të interesit dhe jo rënie. Këto shpenzime mund të ulen me përmasimin e performancës së gjykatave, gjë e cila do krijonte hapësirë për uljen e normave të interesit në kredi.

**Profiti** – Më lartë dokumentuam se nga 14.2% të hyra nga interesi, dhe nga tarifat e tjera që bankat marrim nga klientët e saj, rreth 34 milion Euro mblidhen këtu. Edhe pse një vlerë e tillë duket e lartë për çdo individ që e kujton në mendje, për një sistem bankar që ka investuar 311 milion euro kapital është normale.

Për fund, dua ta ritheksoj se normat aktuale të interesit janë të larta dhe vështirë të përballueshme nga shumica e individëve dhe bizneseve në Kosovë. Sidoqoftë, problematika nuk qëndron tek bankat komerciale, por tek shteti i Kosovës që ka krijuar një ambient të brishtë ekonomik dhe juridik në vend. Për më tepër, fakti më shqetësues është se në këto rrethana aktuale, bankat nuk kanë levërdi të punojnë nën 11.5% normë mesatare të interesit, përndryshe ato do operonin me humbje, që është në kundërshtim me disa deklaratat se bankat duhet të punojnë me 6%, 8% apo 10%. Krahasimi me vende të tjera është i gabueshëm, pasi që situata ekonomike dhe juridike është shumë e ndryshme.

Skenario historike dhe hipotetike e sistemit bankar (vlerat në miliona Euro)

Viti	2008		2009		2010		2011		2012		Mesatarja për 6 vite		Mesatarja	Mesatarja	Mesatarja	
	Historik	Pa fitim	Historik	Pa fitim	Historik	Pa fitim	Historik	Pa fitim	Historik	Pa fitim	Historik	Pa fitim	Humbje	Humbje	Humbje	
<b>Skenario</b>																
<b>Norma efektive mesatare e interesit</b>	14.70%	11.10%	14.30%	11.60%	14.60%	11.50%	14.10%	11.05%	13.40%	11.80%	14.20%	11.48%	10.00%	8%	6%	
<b>Total të hyrat e sistemit bankar</b>	195		203.3		217.2		240		247.2		221	186				
<b>Të hyrat nga interesi</b>	155.7	117.7	164.6	133.2	175.8	138	195.0	152.8	199.8	176.4	178.2	143.6	125.3	100.2	75.2	
Shpenzimet e interesit	-43.1	-43.1	-52.1	-52.1	-55.3	-55.3	-58.4	-58.4	-63.1	-63.1	-54.4	-54.4	-54.4	-54.4	-54.4	
Shpenzimet e provizionit	-22.8	-22.8	-33.4	-33.4	-28.3	-28.3	-34.2	-34.2	-50.2	-50.2	-34	-33.8	-33.8	-33.8	-33.8	
Shpenzimet operative	-91.1	-91.1	-86.4	-86.4	-95.8	-95.8	-105	-105.2	-111	-110.5	-97.8	-97.8	-97.8	-97.8	-97.8	
Profiti para të hyrave tjera	-1.3	-39.3	-7.3	-38.7	-3.6	-41.4	-2.8	-45	-24	-47.4	-8	-42.4	-60.7	-85.8	-110.8	
Të hyrat tjera	39.3	39.3	38.7	38.7	41.4	41.4	45	45	47.4	47.4	42.4	42.4	42.4	42.4	42.4	
<b>Total profiti i sistemit bankar</b>	38	0	31.4	0	37.8	0	42.2	0	23.4	0	34.4	0	-18.3	-43.4	-68.4	

**Vërejtje:** Të dhënat statistikore janë marrë nga Banka Qendrore e Kosovës. Analiza në mesatare për 6 vite, për shkak që analiza vetëm për një vit mund të mos e tregon gjendjen reale të sistemit bankar. Arsyetimi i analizës me të hyra totale është për shkak që banka mund t'i paguaj punëtorët e vet edhe nga të hyrat tjera.

# Roli dhe rëndësia e funksionit të pajtueshmërisë në banka

Në zhargonin bankar, termi “pajtueshmëri” nënkupton respektimin e një sërë ligjeve, rregulloreve, rregullave, standardeve e praktikave më të mira të zbatueshme për aktivitetet e ndryshme bankare. Në përgjithësi, këto ligje, rregullore e standarde kanë të bëjnë me çështje si respektimi i standardeve të sjelljes në treg, menaxhimi i konflikteve të interesit, trajtimi i klientëve në mënyrë të drejtë dhe ofrimi i këshillave adekuate për ta, etj. Veçanërisht, këtu përfshihen edhe çështjet specifike si parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe ligjet relevante tatimore. Për më tepër, dimensionin e pajtueshmërisë shkon përtej asaj që është ligjërisht e detyrueshme duke përfshirë standarde më të gjera të integritetit dhe të sjelljes etike.

Nisur nga fakti se ekzistenca e një ligji ose e një rregullore do të ishte e pakuptimtë nëse nuk do të impononte nevojën për ta zbatuar atë, lehtë mund të konkludohet se aktiviteti i pajtueshmërisë, në një formë apo tjetër është i vjetër sa vetë rregullat dhe ligjet.

Funksioni i pajtueshmërisë në kuadër të bankave ka evoluar me kalimin e kohës. Në ditët e sotme, pavarësisht se si është i organizuar funksioni i pajtueshmërisë në një bankë, ai duhet të jetë i pavarur dhe me resurse të mjaftueshme, përgjegjësitë e tij duhet të specifikohen në mënyrë të qartë dhe aktivitetet e tij duhet të jenë subjekt i rishikimit periodik dhe të pavarur nga ana e funksionit të auditimit të brendshëm. Komiteti i Bazelit i Mbikqyrjes Bankare konceptin e pavarësisë e definon duke përfshirë katër elementë të ndërlidhur. Së pari, funksioni i pajtueshmërisë duhet të ketë status formal brenda bankës. Kjo nënkupton aprovimin e politikës së pajtueshmërisë apo të ndonjë dokumenti formal përmes së cilit rregullohet roli, autoriteti dhe pavarësia e funksionit të pajtueshmërisë. Së dyti, duhet të ketë një zyrtar të pajtueshmërisë si udhëheqës të funksionit, i ngarkuar me përgjegjësi të përgjithëshme për koordinimin e identifikimit dhe menaxhimit



**ALI KRASNIQI**

UDHËHEQËS  
I PAJTUESHMËRISË  
DHE AML

BANKA  
KOMBETARE  
TREGTARE

të riskut të pajtueshmërisë së bankës, dhe për mbikqyrjen e personelit tjetër të funksionit të pajtueshmërisë. Së treti, personeli i funksionit të pajtueshmërisë, dhe në mënyrë të veçantë, udhëheqësi i pajtueshmërisë, nuk duhet të vendoset në një pozicion ku ka konflikt të mundshëm interesi midis përgjegjësive të tyre të pajtueshmërisë dhe të ndonjë përgjegjësie tjetër që mund të kenë. Së katërti, personeli i funksionit të pajtueshmërisë duhet të ketë qasje në informatat e nevojshme që i mundësojnë të përbush detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

Shumica e bankave kanë të themeluar, në kuadër të strukturës së tyre organizative, departamentin e pajtueshmërisë të cilit përgjithësisht i besohen një gamë e gjerë e detyrave dhe përgjegjësive. Varësisht nga institucioni, këto detyra dhe përgjegjësi mund të përfshijnë sigurimin e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, këshillëdhënien, parandalimin e konfliktit të interesit dhe parandalimin e pastrimit të parave, identifikimin, matjen dhe vlerësimin e riskut të pajtueshmërisë, monitorimi dhe raportimi, etj. Risku i pajtueshmërisë definohet si risku nga sanksionet ligjore ose rregullore, humbjet financiare materiale, ose dëmtim të reputacionit që një bankë mund të vuaj si rezultat i dështimit të saj për të qenë në pajtueshmëri me ligjet, rregulloret, rregullat, standardet vetë-rregulluese të institucionit dhe kodet e sjelljes të zbatueshme

për aktivitetet e saj bankare. Një bankë e cila dështon për të marrë në konsideratë ndikimin e veprimeve të saj për aksionarët, klientët, punonjësit dhe tregun, mund të përballet me publicitet negativ dhe dëmtim të reputacionit.

Duke pasur parasysh natyrën e biznesit bankar, nevojën e harmonizimit të aktivitetit të saj me standarde, legjislacion primar dhe sekondar gjithnjë e më kompleks dhe kërkes, roli i funksionit të pajtueshmërisë është kyç për të sigu-

ruar mbarëvajtje të afarizmit dhe harmonizim të interesave të të gjitha palëve të interesit. Është shumë me rëndësi që pajtueshmëria të mos shihet vetëm si përgjegjësi e personelit të specializuar të funksionit të pajtueshmërisë. Ajo ka të bëjë me të gjithë punonjësit e bankës, pavarësisht pozitës, dhe duhet të shihet si pjesë integrale e kulturës së brendshme dhe e afarizmit të bankës.

## Forumi i sigurisë bankare bashkon bankat e Shqipërisë dhe Kosovës në Prizren

Forumi i Tretë Kombëtar për Sigurinë Bankare është mbajtur në Prizren me datën 28 Maj 2014, për herë të parë me bashkorganizim të shoqatave bankare të Shqipërisë dhe Kosovës.

Qëllimi i Forumit ishte që të bashkoj ekspertët nga fusha e sigurisë bankare të cilët në tryezën e organizuar diskutuan rreth temave aktuale dhe zhvillimeve më të fundit në lëminë e sigurisë, me ç'rast u adresuan dy elementet e sigurisë bankare, pra asaj fizike dhe të informacionit. Sesioni i pasdites i rezervuar për sigurinë e informacionit ishte risi në Forum të këtij viti, me synimin që Forumi të marrë përmasa më të mëdha si dhe të përfshijë një tematikë që ka rëndësi të lartë në sektorin bankar. Në këtë mënyrë sektori bankar ka dëshmuar se është duke realizuar masat mbrojtëse të sigurisë për një sistem të sigurtë financiar në vend.

Krahas përfaqësuesve të bankave nga të dy vendet, pjesëmarrës dhe kontribues në Forum ishin edhe përfaqësuesit nga Policia e Kosovës, bankat qendrore të dy vendeve, Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale, i ftuari nga Maqedonia nga NLB Tutunska Banka si dhe kompani të huaja që ofrojnë zgjidhje në lëmin e sigurisë së informacionit.

Në kuadër të organizimit të Forumit në Kosovë, është realizuar dhe vizita e Kryesisë së Komitetit të Sigurisë Fizike të Shoqatës së Bankave të

### XHANAN KARAQA

KRYESUESE E  
KOMITETIT PËR  
SIGURI NË SHBK

DREJTORE  
E SHËRBIMIT  
PËR SIGURI



Shqipërisë në Prishtinë. Me këtë rast janë vizituar dy degë të bankave në Prishtinë për të parë për së afërmi se si është organizuar siguria në banka, pastaj mjediset e një kompanie private që kryen shërbime të sigurisë fizike në banka dhe përfaqësues të Departamentit për Shërbimet Private të Sigurisë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në mënyrë që të shkëmbehen praktikat dhe përvojat në këtë fushë.

Së fundi, domosdoshmëria për organizime të këtilla në nivel më të gjerë, si ai rajonal është vlerësuar nga pjesëmarrësit dhe organizatorët prandaj dy Shoqatat do të vazhdojnë bashkëpunimin në të ardhmen në përpjekje të zgjerimit dhe pasurimit të këtij Forumi.



# Shpëlarja e parave, njëra nga sfidat e sektorit bankar

Shpëlarja e parave është një vepër penale e dënueshme me ligj. Për shkak të sasive të mëdha të parave të përfshira në procesin e shpëlarjes së parave dhe duke pas parasysh faktin se në disa vende në zhvillim, siç është ta zëmë Kosova, që kanë buxhet të vogël, këto të ardhura të paligjshme mund të kenë ndikim të madh në buxhetin e vendit. Kjo mund të shkaktojë një humbje të kontrollit edhe në politikat makroekonomike të vendit dhe mund të rezultoj edhe me gabime të matjes së statistikave makroekonomike, që dalin nga shpëlarja e parave. Shpëlarja e parave mund të ndikojë negativisht në ofertën e parasë si dhe në normat e kthimit, sepse pastruesit e parave i riinvestojnë fondet e tilla në ato asete, ku skenarët e tyre të shpëlarjes së parave ka më pak të ngjarë që të zbulohen nga institucionet e ndryshme se sa në vend të investimit në ato asete ku kthimi është më i lartë.

Meqenëse ekonomia e Kosovës është e bazuar në para të gatshme, kjo e bën Kosovën si vend më të prekshëm për aktivitete të shpëlarjes së parave dhe financim të terrorizmit. Menjëherë pas luftës së fundit të vitit 1999 kishte një numër të madh investimesh në Kosovë, duke rezultuar kështu me një numër të madh njerëzish të pasur. Me një ekonomi të sapodalur nga lufta, padyshim u paraqit nevoja të krijohet një rregullativë ligjore, e cila do të mundësonte luftimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, prandaj në vitin 2004 Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë do të krijonte një rregullore, rregullorja e UNMIK-ut Nr.2004 / 2, ku fokusi kryesor i saj ishte parandalimi i shpëlarjes së parave dhe veprave të ngjashme penale . Në bazë të kësaj Rregulloreje u krijua edhe Qendra e Inteligjencës Financiare. Pasi kaluan mbi gjashtë vite u paraqit nevoja e krijimit të një ligji të ri, i cili zëvendësoi rregulloren 2004/2. Ky ishte Ligji Nr 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe finan-



## ALBAN HETEMI

ZYRTAR I LARTË  
I PAJTUESHMËRISË  
DHE AML

PROCREDIT BANK

cimit të terrorizmit, në bazë të të cilit u krijua Njësia e Inteligjencës Financiare e Republikës së Kosovës (NJIF-K), institucion ky i pavarur kombëtar në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, përgjegjëse për kërkimin, mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informatave tek autoritetet kompetente që kanë të bëjnë me luftimin e shpëlarjes së parave dhe financimi të terrorizmit. Ky ligj, në vitin 2013, u plotësua dhe u ndryshua nga ligji 04-L-178 "Ndryshim dhe plotësim i ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave".

Pavarësisht fakti se janë marrë shumë masa, korrupsioni dhe shpëlarja e parave mbeten ende një shqetësim dhe një sfidë serioze për Republikën e Kosovës dhe bankat në veçanti. Ndërsa, reformat që lidhen me korrupsionin dhe shpëlarjen e parave janë duke u bërë në vazhdimësi e sipër për vite me radhë.

Republika e Kosovës nuk është një qendër e rëndësishme financiare apo "offshore country" që njihet si term, megjithatë, si një vend tranzit për trafikimin e narkotikëve, armëve, kontrabandës dhe kontrabandës së emigrantëve, prapë mbetet si një vend me rrezik të konsiderueshëm për shpëlarje të parave.

Shumica e të ardhurave nga aktivitetet e kontrabandës besohet të kenë shkuar direkt në ekonominë në fusha të tilla si ndërtimi dhe pasuri të patundshme, dyqanet e shitjes me pakicë, banka, shërbime financiare, kazino dhe kompani tregtare. Shumat më të vogla mendohet të jenë shpëlarë nëpërmjet sistemit financiar. Ka disa të dhëna se ekonomia e bazuar në tregti përdoret për shpëlarje të parave në formën e mbi dhe nën faturimit (Burimi: United States Department of State International Narcotics Control Strategy Report (INCSR) 2010).

Edhe përkundër faktit se Kosova nuk është immune ndaj shpëlarjes së parave, sikurse asnjë shtet tjetër, vlen të theksohet se është bërë një progres në luftimin e shpëlarjes së parave. Bashkëpunimi në mes të NJIF-K dhe sektorit bankar janë duke luajtur një rol crucial në luftimin e shpëlarjes së parave, sidomos në sektorin financiar. Ky bashkëpunim ka dhënë frutet e tij edhe në praktikë.

## Rëndësia e edukimit financiar

Që nga viti 2000 sektori bankar i Kosovës u zhvillua në mënyrë shumë dinamike; Avancimi dhe zgjerimi i operacioneve bankare po kontribuon vazhdueshëm në rritjen e mundësive për qasjen e të gjitha shtresave të shoqërisë, duke krijuar kështu mundësi për një shfrytëzim më të madh të potencialeve financiare në vend; Megjithatë gjatë kësaj periudhe është punuar më shumë në drejtim të shitjes, sesa të një shpjegimi të plotë të shërbimeve të ofruara dhe si rrjedhojë edukimi financiar i klientëve nuk ka ndjekur mjaftueshëm zhvillimin e shpejtë të shërbimeve bankare në vendin tonë.

Sektori bankar në Kosovë është një nga sektorët më të zhvilluar dhe më të modernizuar të eko-



nomisë, dhe nëpërmjet ndërmjetësimit financiar ky sektor është një kontribues i fuqishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Me avancimin dhe zgjerimin dinamik të sektorit bankar në Kosovë është rritur edhe konkurrenca ndërmjet bankave që rrjedhimisht ka ardhur si rezultat i rritjes së laramanisë së shërbimeve bankare që iu është servuar klientëve kosovarë. Po bëhet jo e lehtë për klientët që të orientohen brenda një morie shërbimesh bankare dhe të jenë në gjendje të zgjedhin shërbimin e duhur për të përmbushur nevojat e tyre. Ky zhvillim i shpejtë i shërbimeve bankare nuk ka ecur krah për krah

me ritmin e njohurive financiare të qytetarëve dhe shpesh herë një gjë e tillë nuk është përputhur me përpjekjet për të mbizotëruar motivin e shitjes – pra për tu udhëhequr mbi parimin e një institucioni të përgjegjshëm financiar që në vend të shitjes, prioritet do të kishte këshillimin e klientëve për rëndësinë që vendimet e tyre t'i bazojnë në ato shërbime bankare, të cilat nuk përkeqësojnë gjendjen e tyre financiare dhe nuk thellohen në borxhe.

Andaj konsiderojë që i tërë sektori bankar në Kosovë do të duhej të luaj një rol edhe më aktiv që të përdorë ekspertizën dhe teknikën e duhur për të avancuar tutje edukimin e klientëve karshi të drejtave dhe obligimeve që përcaktohen nga raportet klientë – bankë, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të kontribuojmë në krijimin e një shtrese më të qëndrueshme shoqërore dhe një sistem stabil dhe të besueshëm bankar.

### **Edukim financiar për një mirëqenie më të madhe të klientëve**

Sot bota financiare është bërë shumë komplekse dhe është shumë e rëndësishme që shfrytëzuesit e shërbimeve bankare të kenë njohuri të mjaftueshme mbi përparësitë dhe mangësitë e shërbimit specifik bankar në mënyrë që të jenë në gjendje që ti menaxhojnë në mënyrë të suksesshme buxhetin e tyre personal. Si rrjedhojë e kësaj, shumë individë dhe biznese në botën perëndimore si psh. disa shtete të zhvilluara, viteve të fundit nuk udhëhiqen mbi parimin se si dhe me cilat institucione financiare të bashkëpunojnë gjë që thelloi edhe më shumë krizën financiare duke e rritur ngarkesën e individëve në borxhe dhe rrezikuar të ardhmen e tyre financiare.

Pra, duke e pasur këtë përvojë jo të mirë të vendeve të tjera në raport me kreditimin agresiv dhe çmimet jo-transparente është shumë e rëndësishme që institucionet financiare të jenë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, duke i bazuar vendimet në analizë të shëndoshë financiare, në gjendjen ekonomike të klientëve, potencialin e bizneseve dhe kapacitetin për pagesë, në mënyrë që klientët të mund të përfitojnë nga shërbimet më të përshtatshme bankare, përfshirë kreditë. Në këtë kontekst, mos promovimi i kulturës konsumuese është thelbësore. Në vend të kësaj, të promovohet kultura e kursimit dhe

shërbimet bankare që iu mundësojnë individëve dhe familjarëve shtim të vlerës së investimit.

Edukimi financiar duhet lidhur ngushtë me shëndetin dhe mirëqenien financiare të klientëve; Një klientë mirë i informuar do të jetë në gjendje që të merr vendime të matura në lidhje me të hollat e tyre dhe do ta shpinte atë për të kuptuar se si të mbrohet nga ndonjë zhvillim eventual i padëshirueshëm; Në këtë mënyrë edukimi financiar do të siguronte një përmirësim të standardit jetësor të klientët e që një situatë e tillë do ta kualifikonte edukimin financiar të klientëve vlerë të shtuar të shoqërisë.

Jo vetëm kaq; Bashkëpunimi me një klientelë të edukuar financiarisht do të shtonte efikasitetin e tregut sepse një klientë i mirë informuar në lidhje me instrumentet e ndryshme financiare do të ishte më kërkues karshi shërbimeve bankare – dhe një gjë e tillë do të sillte një ambient më të avancuar e më konkurrentë për të zhvilluar karakteristikat e shërbimeve bankare që do të mund të përmbushnin më mirë nevojën e klientit.

### **Iniciativa “Mëso më shumë”**

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e edukimit financiar, që nga viti 2008 ProCredit Bank në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës ka ndërmarrë iniciativën “Mëso më shumë” që i dedikohet të gjithë klientëve me qëllim që këta të fundit të mund të marrin vendime të mençura dhe të përgjegjshme për zgjedhjen e bankës dhe shërbimeve që i nevojiten, e posaçërisht kur të marrin kredi. Për këtë arsye ne kemi hartuar materiale të nevojshme që trajtojnë çështje të ndërtimit dhe planifikimit të buxhetit familjarë, rëndësinë e kursimeve, elementet që duhet pasur parasysh para se të zgjidhet një kredi, informacione mbi kalkulimin e kostosë së kredive, dhe shumë informacione të tjera, në mënyrë që çdo klient të ketë një vendimmarrje financiare me impakt pozitiv për ekonominë individuale, por edhe ekonominë e Kosovës në veçanti.

# Zhvillimi i Tregut Financiar të Patundshmërisë në Kosovë

Së bashku me ajrin e pastër, ujin, ushqimin, shëndetësinë, arsimin dhe sigurinë, e drejta për strehim të përshtatshëm është e njohur nga ligjet ndërkombëtare, traktatet dhe nga Kombet e Bashkuara (UN) si një nga të drejtat themelore të njeriut dhe nevojat e të gjithë njerëzimit<sup>1</sup>. Edhe pse Qeveria në mënyrë të qartë ka një rol të luaj, sidomos pasi ajo lidhet me të varfërit, strehimi është krejtësisht ndryshe nga shumica e nevojave të tjera kyçe për shkak se financimi i strehimit mund të jetë kryesisht një sipërmarrje e sektorit privat.

Megjithatë, që një sistem i qëndrueshëm financiar i strehimit të ekzistojë në Kosovë, Qeveria duhet të zhvillojë një mjedis të favorshëm për bizneset si dhe një seri të duhur të strukturave rregullatore dhe stimuj që do të inkurajojnë kapitalin privat për të investuar në strehim dhe financim të strehimit. Për të krijuar mjedis të duhur për bizneset, Qeveria e Kosovës duhet të bashkëpunojë me të gjithë akterët për të siguruar që të gjitha aspektet e zhvillimit të sektorit të strehimit dhe të sistemeve të financave të strehimit të funksionojnë me një shkallë të lartë të besueshmërisë dhe integritetit në përputhje me karakteristikat historike, kulturore dhe ekonomike të Kosovës. Qeveria e Kosovës gjithashtu ka nevojë që të bashkëpunojë me grupet e interesit për të përcaktuar se cilët janë stimujt e duhur që do të mbështesin më mirë burimet e sektorit privat në ofrimin e strehimit dhe zhvillimin e sistemit

## WILLIAM DONOVAN

KËSHILLTAR  
REZIDENT

THESARI I SHBA-ve,  
ZYRA E ASISTENCËS  
TEKNIKE



të financave të strehimit. Këta stimuj duhet të peshohen me kujdes kundrejt aftësive financiare dhe të përgjegjësive të tjera të Qeverisë për të ofruar këta stimuj me një shkallë të lartë të besueshmërisë dhe integritetit.

Projekti për financim të banimit (PFS) filloi në Mars 2012 në mbështetje të dëshirës së Qeverisë së Kosovës për të përmirësuar sektorin e financave të banimit. Projekti është i financuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë dhe menaxhohet nga Thesari i SHBA-ve, gjegjësisht Zyra e Asistencës Teknike. PFB mbështet drejtpërdrejt përpjekjet e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) dhe Ministrisë së Financave (MF) në zhvillimin e një mjedisi të përshtatshëm që mundëson financimin e strehimit duke punuar me grupet e interesit të ndryshme të sektorit publik dhe privat që janë kyc ose mbështesin sistemin e financave të strehimit. Mbështetja e guvernatorëve të Bankës Qendrore të Kosovës-Gani Gërguri dhe Bedri Hamza- ka qenë me rëndësi kritike në përpjekjet e PFS-së. Në veqanti, Bedri Hamza, së pari si ministër i Financave dhe pastaj si Guvernator, ka ofruar mbështetje jetike për projektin veçanërisht përmes mbështetjes së personelit dhe udhëzime nëpërmjet bashkëveprimit me Qeverinë dhe grupet e interesit të sektorit privat.

<sup>1</sup> E drejta për Strehim të Përshtatshëm, Fletë faktesh Nr. 21/Rev.1, UN Habitat, Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejta të Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara

Në vitin 2012, bruto produkti vendor i Kosovës ishte € 4.9 miliard. Sipas të dhënave në databazën e hipotekave të BQK-së, vlera e hipotekave rezidenciale të pazgjdhura në fund të vitit 2012 ishte vetëm €140.6 milion, ose vetëm 2.9% të bruto produktit vendor. Tabela e mëposhtme jep

një krahasim me vendet e tjera të rajonit dhe me vendet më të zhvilluara për t'i dhënë këtij numri kuptim. Raporti i nivelit të kredive hipotekare të papaguara ndaj bruto produktit vendor në Kosovë është sa gjysma e normës për vendin tjetër më të afërt në rajon.

### Vlera e Kredive Hipotekare Të Papaguara si Përqindje (%) të BPV - 2012

Shteti	Përqindja	Shteti	Përqindja
Shqipëria	7.7% <sup>H</sup>	Austria	27.7%
Bullgaria	17.6%	Spanja	61.1%
Krocia	32.6%	Republika Çeke	14.3%
Gjeorgjia	5.8% <sup>H</sup>	Turqia	5.9% <sup>H</sup>
Serbia	8.2% <sup>H</sup>	Zvicrra	139.8% <sup>H</sup>
Slovenia	14.8%	SHBA	68.8%

**Burimi:** Federata Hipotekare Europiane, Hypostsat, Helgi Analytics (shënuar me një 'H') i përkasin 2011

Kosova ka hapësirë për rritje në origjinimin e hipotekave. Meqë bankat në Kosovë aktualisht kanë likuiditet të tepërt, çështja do të jetë se a do të bëhet operacionalisht efikas dhe i vetë-qëndrueshëm sistemi për financimin e strehimit. Gjitha shqetësimet rreth çështjeve me menaxhimin e aseteve / detyrimeve janë të lehtësuara me përdorimin e hipotekave me normë të ndryshueshme, të cilat përdoren aktualisht nga bankat lokale. BQK-ja është duke planifikuar për të futur në treg rregullat hipotekare në vitin 2014 dhe është duke u përpjekur për të koordinuar dhe integruar funksione të ndryshme në një sistem të unifikuar financiar të strehimit. Nëse është i suksesshëm, origjinimi i hipotekave lehtësisht mund të dyfishohet në vitet e ardhshme, duke lejuar më shumë njerëz të pronësojnë shtëpitë e tyre. Kjo do të lehtësonte edhe presionin mbi ndërtuesit për të rregulluar financimin për blerësit.

Edhe pse financimi hipotekar është fokusi kryesor i PFS, ka shumë çështje që kanë një efekt të rëndësishëm në sistemin e financave të strehimit, dhe meritojnë konsideratë. Për këtë arsye, PFS ka zhvilluar shtatë objektiva të zhvillimit në bazë të "12 detyrave Herkuleane" të identifikuar në librin e Bankës Botërore, *Politikat*

e *Financimit të Strehimit në Tregjet në Zhvillim*<sup>2</sup> (Redaktuar nga Loïc Chiquier dhe Michael Lea). Secila nga këto qëllime të zhvillimit kanë grupet e tyre të veçanta të interesit dhe nevoja të zhvillimit. PFS (Politika e Financimit të Strehimit) është përpjekur për të trajtuar secilën prej këtyre qëllimeve për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit financiar të strehimit. Kjo ka kërkuar përdorimin e këshilltarëve të përkohshëm, koordinim me projektet tjera zhvillimore në identifikimin e çështjeve që duhet të adresohen, dhe, në disa raste, bërjen e rekomandimit të projekte të reja për financim.

**Krijimi i një regjimi efektiv rregullator është qëllimi i parë i zhvillimit është,** i cili është fokusi kryesor i PFS. Nuk kishte rregulla specifike mbi kreditë hipotekare përtej disa referencave në kuadrin e përgjithshëm të rregullave bankare, kur filloi projekti. PFS kryejti një rishikim të gjerë të ligjeve ekzistuese dhe rregullave, të cilat ndikojnë në financimin e strehimit dhe përgatiti një rekomandim në lidhje me zhvillimin e një baze të plotë ligjore për përmirësimin e mjedisit për financimin e strehimit. Ishte vendosur se koha nuk ishte e duhur për të ndryshuar ndonjë prej ligjeve për arsye politike dhe praktike, prandaj, PFS

2 [http://siteresources.worldbank.org/FINANCIALSECTOR/Resources/HousingFinanceforEMs\\_Ebook.pdf](http://siteresources.worldbank.org/FINANCIALSECTOR/Resources/HousingFinanceforEMs_Ebook.pdf)

vazhdoi me zhvillimin e rregulloreve të matura në bazë të ligjit ekzistues. Rregullat do të mbulojnë të gjitha aspektet e kredidhënies hipotekare rezidenciale në mes të tjerash – origjinimin hipotekar, praktikat e nënshkruara, dokumentacionin e kredive, shërbimin e dhënë, raportimin e kredive, mjaftueshmërinë e kapitalit.

**Një tipar kyç i një sistemi të financave të strehimit funksional është përdorimi i dokumenteve të standardizuara të hipotekës dhe standardeve specifike për kredi që të kualifikohen për qëllime investimi – duke përfshirë udhëzime të nënshkruara, strukturën e hipotekave, vlerësimet, kërkesat për dhënie të shërbimeve. Realizimi i këtij qëllimi të dytë të zhvillimit do të çojë në një treg më efikas hipotekash, i cili do të lehtësojë zhvillimin e një tregu sekondar hipotekash. Në bashkëpunim me një grup punues të bankave dhe palëve të tjera relevante, PFS është përpjekur të racionalizojë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha aspektet e kredidhënies hipotekare. Është e rëndësishme të theksohet se BQK-ja ligjërisht nuk mund të kërkojë përdorimin e një marrëveshjeje të standardizuar hipotekare, por mund të mbështet miratimin e saj. PFS është duke u përpjekur të krijojë një grup pune me akterët e interesuar, veçanërisht me SHBK-në dhe organizatën e Noterëve e cila mund të zhvillojë dhe ruaj dokumente të standardizuara hipoteke. Kjo mund të koordinohet me një ose më shumë projekte të USAID-it.**

**Qëllimi i tretë është duke e mbështetur ofrimin e vetëdijësisimit të publikut për çështjet e financave të strehimit.** Në përputhje me këtë qëllim, PFS ka ofruar trajnime për BQK-në dhe stafin e bankave private mbi bazat e hipotekave dhe kreditë hipotekare. Trajnime shtesë do të ofrohen me futjen e rregulloreve hipotekare nga ana e BQK-së. Përveç kësaj, mbështetje do t'i jepet BQK-së dhe MF-së lidhur me përpjekjet e përgjithshme të vetëdijësisimit publik për të edukuar publikun mbi përgjegjësitë që konsumatori merr kur blen një shtëpi apo banesë me një kredi hipotekare. Në veçanti, PFS ka zhvilluar një udhëzues konsumatorësh për hipotekat. Ajo është duke koordinuar prodhimin e këtij udhëzuesi me projektin e Bankës Botërore për mbrojtjen e konsumatorëve. Ajo do të publikohet së bashku me lëshimin e rregulloreve të hipotekës.

**Disponueshmëria e financimit afatgjatë për kreditë hipotekare është vendimtare për zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm financiar të strehimit që është një synim afatgjatë.** Pothuajse të gjitha aktivitetet në zhvillimin e sistemit financiar të strehimit – duke përfshirë projektimi i produktit hipotekar dhe standardizimi, rregullativa e matur e huadhënësve, infrastruktura për të siguruar vlerësimin e duhur dhe efikasitetin e tregut, -përqendrimi në bërjen e hipotekave një investim tërheqës për investitorët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Këtij qëllimi për zhvillim afatgjatë do t'i duhet një sistem i financimit të strehimit që funksionon në mënyrë efektive për të tërhequr këta investitorë të mundshme. PFS ka bërë disa përpjekje për të zhvilluar interes paraprak për të investuar në hipotekat në Kosovë.

**Një qëllim tjetër është mbështetja e zhvillimit të institucioneve si dhe legjislacionin dhe procedurat e nevojshme që do të sigurojnë se pronësia e tokës dhe pronës janë të identifikuar siç duhet dhe transferimi i pronës është i regjistruar në mënyrë efektive. Kjo është thelbësore për një sistem plotësisht funksional të financimit të strehimit.** PFS ka monitoruar aktivitetin në këtë sektor për të siguruar që aktivitetet janë në përputhje me nevojat e një sistemi të qëndrueshëm financiar të strehimit. Qeveria e Kosovës ka bërë hapa të jashtëzakonshëm në regjistrimin dhe dokumentimin e pronës përmes Agjencisë Kadastrale të Kosovës ("AKK-së"), së bashku me iniciativë të tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi tokën. Përveç kësaj, zonimi dhe planifikimi i përdorimit të tokës janë integrale për të siguruar që prona mund të arrijë përdorimin e saj më të lartë dhe më të mirë, në të njëjtën kohë duke realizuar qëllimet sociale dhe ekonomike. Kjo përpjekje është mbështetur nga projektet e USAID-it si Projekti për Mundësimin e Mjedisit për Biznese (BEEP).

PFS ka kryer një studim të gjerë të ndërtuesve në Kosovës për të krijuar një bazë të aktiviteteve financiare për industrinë e ndërtimit. Me një normë të përgjigjes prej pak më shumë se 50 përqind, rezultatet zbuluan se një pjesë e madhe e transaksioneve bëhet përmes këmbimit në ndërtim dhe se financimi bëhet përmes përfshirjes modeste të industrisë bankare në

financimin e ndërtimit dhe blerjen e pronave nga konsumatorët. Shpresojmë se PFS mund të ndihmojë në përmirësimin e përfshirjes së bankës në financimin e strehimit.

Përveç kësaj, me mbështetjen ligjore të Projektit të USAID - BEEP, PFS morri pjesë gjerësisht në hartimin e ligjit të ri për Ndërtesat e banimit në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Këto përpjekje shpresojmë se ndihmuan në zhvillimin e një regjimi rregullativ efektiv për zhvillimin mbi pronat në pronësi të përbashkët.

Një qëllim tjetër i PFS është të mbështesë zhvillimin e infrastrukturës për financim të strehimit për të mbështetur sistemin e financave të strehimit. Pjesëmarrësit e ndryshëm mbështetës në sistemin e financave të strehimit, vlerësuesit, agjentët e pasurive të patundshme, noterët dhe të tjerë nevojitet të merren parasysh në mënyrën se si ata ndërveprojnë në sistem dhe se si ata mund të ndihmohen në zhvillimin e tyre. Për shembull, Regjistri Kreditorë i Kosovës ("RKK") e BQK-së ofron informata individuale të kredisë për institucionet kredidhënëse dhe subjekteve të kredisë. PFS ka shqyrtuar RKK-në dhe gjeti disa fusha për përmirësim të mundshëm të cilat janë nën shqyrtim.

PFS këshilloi BQK-në në marrjen e rolit udhëheqës në zhvillimin e Bordit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme që të rregullojnë vlerësuesit nëpërmjet trajnimit dhe certifikimit. PFS ka këshilluar në negociatat që vendosën Shefin e Rregullores së BQK-së dhe Drejtorin Ekzekutiv të SHBK-së në Bord dhe ka këshilluar në finalizimin e rregulloreve dhe financimin përmes mbështetjes financiare të Bordit Mbikëqyrës nga ministritë kyçe. Regjimi i trajnimeve për vlerësues është rishikuar për të siguruar që të jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare. Përveç kësaj, PFS ka këshilluar mbi zhvillimin e rregulloreve të BQK-së në vlerësimet për institucionet financiare në kredidhënie hipotekare.

PFS ka identifikuar një nevojë për një projekt të fokusuar në organizimin e një organizate vetë-rregulluese për të ofruar trajnim dhe certifikim

për agjentët e patundshmërive si të rëndësishme për zhvillimin e sistemit financiar të strehimit. Është e mundur që një tjetër donator të marrë këtë detyrë.

**Së fundi, qëllimi i krijimit të një Politike Gjithëpërfshirëse Kombëtare të Strehimit është një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet Qeveria e Kosovës.** Qëllimi i një politike të tillë do të ishte koordinimi dhe prioritet në kuadër të Ministrive të ndryshme të Qeverisë, shumë çështje kombëtare dhe rajonale që duhet të adresohen. Ato përfshijnë zgjidhjen e çështjeve të tilla si regjistrimin e duhur të tokës; zgjidhjen e barabartë të mosmarrëveshjeve për tokë; krijimin e ligjeve dhe rregulloreve efektive në lidhje me kodet e ndërtimit dhe të zonimit; shpërndarjen e shërbimeve komunale; efektet e zhvendosjes së popullsisë nga lufta; së bashku me shumë çështje të tjera etnike, sociale dhe politike.

Kompleksiteti i këtyre çështjeve nuk duhet të dekurajoj Qeverinë që të zhvillojë një proces për adresimin e nevojës për një Politikë Gjithëpërfshirëse Kombëtare të Strehimit sepse siç u tha më herët, strehimi është një nevojë themelore njerëzore. Për më tepër, një treg i patundshmërive stabil dhe i zhvilluar mund të jetë një kontribut i madh në përmirësimin e ekonomisë së Kosovës. Varësisht se si e numëron efektin shumëzues të ndërtimit bazë të shtëpive, strehimi mund të kontribuojë diku nga pesë në njëzet përqind të BPV-së. Ky proces mund të çojë në kushte të drejta dhe të barabarta të jetesës për të gjithë Kosovarët (nga të varfërit rural dhe urban deri te klasa e mesme që është në rritje) dhe do të jetë pjesë themelore që mbështet rindërtimin e shoqërisë Kosovare dhe ringjalljen e ekonomisë së saj.

*Autori është i punësuar në Thesarin e SHBA dhe reflekton këtë temë vetëm në bazë të opinionit të tij. Ky nuk është automatikisht pozicioni i Thesarit të SHBA apo i ndonjë entiteti tjetër publik i SHBA.*

# Jo vetëm bankat

Për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe stabilitetin e sistemit bankar në vend, nuk janë përgjegjëse vetëm bankat komerciale. Lista e përgjegjësve është e gjatë.

Bankat komerciale në kredi kanë mbi 1,8 miliardë euro. Kjo shumë është 1,2 për qind më e madhe se buxheti i sivjetëm i vendit, ose 36 për qind e BPV-së. Nuk është pak. Mirëpo, kësaj shume duke ia shtuar edhe investimet nga sektori publik nuk ishin të mjaftueshëm për një normë më të lartë të zhvillimit ekonomik, së paku deri në masën sa të nisë rënia e papunësisë dhe e varfërisë.

Nuk janë të rralla kritikrat se fajtor kryesor për këtë gjendje janë bankat komerciale, të cilat secilin vit po thithin paratë nga tregu - në formë të depozitave dhe të kursimeve, ndërsa janë koprrace kur vjen në pyetje dhënia e kësaj paraje, apo kanë koston e lartë të saj. Sipas këtyre kritikëve, bankat duhet të përkrahin strategjinë qeveritare, të ulin çmimin e shërbimit, së bashku me likuiditetin dhe normën e fitimit. Ndërkaq, aktorët e tjerë me ndikim në sistemin financiar të qëndrojnë si spektatorë, ose të presin që të vjelin frutat e këtij investimi.

Kjo është e padrejtë, meqenëse nxitja e zhvillimit dhe stabiliteti në sistemin bankar është problem kompleks, ku bankat janë vetëm një faktor. Madje, nëse llogaritim se ato janë biznes privat-aksionar, atëherë është e kuptueshme pse nuk mund të kenë ndikim aq të madh në ndryshimin e gjendjes aktuale në rrafshin ekonomik dhe social. Ndonëse ato marrin para dhe të njëjtat "i shesin", sërish kjo nuk është e mjaftueshme për t'ia m'veshur këtë përgjegjësi. Për këtë ka shumë arsye.

## IBRAHIM REXHEPI

QENDRA PER  
HULUMTIME  
STRATEGJIKE DHE  
SOCIALE (STRAS)



E para - Bankat kanë përgjegjësi për paratë që kanë marrë në formë depoziti, apo si kursim. Kur kemi parasysh se të tilla i kanë mbi 2,4 miliardë euro, atëherë kjo edhe më shumë e rrit përgjegjësinë e tyre. Pra, duhet të jenë të kujdesshme ku i investojnë këto para, ta kenë parasysh normën e kthimit, të mbulojnë të gjitha shpenzimet që kanë, dhe pronarëve të parasë, në momentin që ata i kërkojnë, t'ua kthejnë së bashku me interesin. Po të ishin të pakujdesshme dhe të rrezikonin këto para, atëherë pasojat nuk do të ishin aq të rënda për bankat, sa për kursimtarët. Dhe së fundit, humbja e depozitave reflekton me tensione sociale e politike. Prandaj, ato nuk guxojnë të hyjnë në këto aventura, madje, për këtë nuk i lejon as BQK-ja, e rregullat e caktuara prej saj.

E dyta - Bankat nuk kanë fuqi, e as autoritet që vet të kujdesen për investimet që bëjnë, ndonëse këtu janë përgjegjësit kryesor. Kjo çështje në mënyrën më të mirë rregullohet përmes respektimit të ligjit, ngritjes së efikasitetit të institucioneve gjyqësore, si edhe bashkëpunimit më të mirë ndër institucional. Kulmi i krejt kësaj janë gjykatat, të cilat duhet të dëshmojnë për funksionimin e shtetit ligjor, por edhe të garantojnë për besueshmërinë e dokumentacionit dhe respektimin e kontratave.



Sikur të ishin më efikase, jo vetëm që do të reflektonin stabilitet, por në të njëjtën kohë nuk do të lejonin që të grumbullohen mbi 10.500 konteste që kanë të bëjnë me bankat, përmes të cilave janë të bllokuara 500 milionë euro. Kjo shumë është e barabartë me 21 për qind të totalit të depozitave, apo 17 për qind të asetëve. Shumë është. Merreni me mend se sa të relaksuara do të ishin bankat sikur këto para të ishin në qarkullim. Madje, ato nuk do të ishin të brengosura për funksionimin e ligjit dhe për respektimin e kontratave.

E treta - Raportimi financiar do të ndryshonte rrënjësisht panoramën për shëndetin e biznesit privat. Për këtë çështje bankat janë të vetmuara. Është bindje e tyre a duan t'iu besojnë raporteve financiare që prezantojnë ata që kërkojnë hua, çështje që mbështet edhe te kapacitete profesionale që kanë ato për reflektimin e kësaj gjendje. E vërteta është se ende ka biznese që operojnë me shumë bilance, të cilët i rregullojnë varësisht nga qëllimi që kanë. Pse duhet të jetë kështu, kur zgjidhje mund të jetë shumë e thjeshtë. Alternativa e parë është që bankat të marrin informata nga Administrata Tatimore e Kosovës për "shëndetin" e bizneseve të caktuara, meqenëse ato i raportojnë vetëm ATK-së. Nëse do të ishte problem që informata të këtilla të ofrojnë për secilën bankë, atëherë çështja mund të rregullohet në relacionin ATK-BQK. Alternativa e dytë është zbatimi i ligjit për raportim financiar, ndërsa huamarrësit potencial bankës t'iu ofrojnë bilance të audituara. Në fakt, nuk ka asnjë ndalesë që këtë kërkesë edhe tash ta bëjnë bankat.

Por, as bankat nuk janë krejtësisht të liruar nga përgjegjësia se duhet të jenë pjesëmarrësve aktive në luftën për zhvillim të përgjithshëm ekonomik dhe ngritjen e mirëqenies sociale të popullatës. Përkundër të gjitha problemeve, nuk duhet harruar faktin se NPL-të në Kosovë edhe më tutje janë në nivelin më të ulët në rajon, ndonëse trendi i rritjes është shqetësues. Mirëpo, bankat aktualisht kanë pasqyrën e sektorëve që kanë aftësi pagese, përkatësisht të kthimit të borxheve, prandaj ndaj tyre duhet të jenë më dorëshlrirë. Po ashtu, të jenë më aktive në trajtimin e problemeve në të cilat hyjnë bizneset, të cilat shpesh ndodhin për shkak të ndryshimeve të befasishme në treg, apo për shkak të parashikimeve të gabueshme. Nëse është fjala për probleme të tejkaluashme, të intervenohet përmes pushimeve kreditore, riprogramimit të borxheve, apo edhe duke intervenuar me qëllim të përmirësimit të likuiditetit të bizneseve. Po ashtu, duke pasur parasysh shkallën e lartë të likuiditetit që kanë bankat, ato mundën që me një përqindje të parasë që kanë në dispozicion, të "favorizojnë" sektorë, apo biznese të caktuara. Prej tyre nuk duhet të kërkojnë fitim të madh, por qarkullim të shpejtë të kapitalit. Kjo atyre bizneseve iu mundëson zhvillim të shpejtë dhe punësim më të madh. Që të dy parametrat janë në të mirë të bankave, meqenëse paraja që krijohet në bizneset, apo të punësuarit do të kthehet në bankë, që në mënyrë direkte ndikon në rritjen e potencialit të sistemit bankar.



# A duhet të implementohet “Bazel II”?

## Pse “Bazel II”?

“Bazel II”, shumë shpesh është diskutuar në shumë qarqe të ekspertëve dhe më pas është kritikuar shpesh: nga pikëpamja neutrale ky me emrin “Bazel II” është me të vërtetë i dyti nga të ashtuquajturat Marrëveshjeve të Bazelit, e krijuar nga qarqe të ekspertëve në Bankën për Marrëveshje Ndërkombëtare në Bazel. Kjo ide përmban rekomandime të rëndësishme për ligjet dhe rregulloret bankare të nxjerra nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare.1)

“Bazel II”, botuar së pari në mesin e vitit 2004, kishte për qëllim krijimin e një standardi ndërkombëtar të harmonizuar për rregullatorët bankar. Kjo ishte e kombinuar me objektivin për të kontrolluar se sa kapital bankat duhet të vënë mënjanë për t’u mbrojtur kundër llojeve të ndryshme të rreziqeve financiare dhe operative me të cilat bankat (dhe me shpresë e gjithë ekonomia) ballafaqohen. Fokusi kryesor ishte ruajtja e konsistencës së mjaftueshme të rregullave, në mënyrë që kjo të mos bëhet një burim i pabarazisë konkurruese në mesin e bankave aktive në tregjet ndërkombëtare. Baballarët e “Bazel II” besonin në atë kohë, se një standard i tillë ndërkombëtar shumë i zhvilluar mund të ndihmojë për të mbrojtur në një mënyrë efikase sistemin financiar ndërkombëtar nga llojet e problemeve që mund të lindin po qese një bankë e madhe ose një seri e bankave kolapsojnë papritmas.

Nga njëra anë: Në botën e teorisë ekonomike, “Bazel II” u përpoq të arrijë këtë duke vendosur

### JOHANNES ENGELS

AUTORITETI  
FEDERAL  
GJERMANI  
MBIKQYRJES  
FINANCIARE  
(BaFin)



kërkesa shumë të thella të rrezikut të diferencuar dhe menaxhimit të kapitalit, të dizajnuara të sigurojnë se institucioni kreditor ka kapital të mjaftueshëm për rrezikun ndaj të cilit kjo bankë ekspozon veten përmes praktikave të saj të kreditimit dhe të investimeve. Në përgjithësi, këto rregulla interesante do të thojnë, se sa më i madh të jetë rreziku ndaj të cilit banka është e ekspozuar, aq më e madhe duhet të jetë shumica e kapitalit institucioni kreditor duhet të mbajë për të ruajtur aftësinë pagueuse të vet dhe stabilitetin e përgjithshëm ekonomik. 2)

Politikisht - nga ana tjetër - ajo ishte në kundërshtim me teorinë e përmendur ekonomike, e vështirë për ta zbatuar “Bazel II” në mjedisin rregullator para vitit 2008, dhe progresi ishte në përgjithësi i ngadalshëm deri në krizën e madhe bankare të atij viti të shkaktuar kryesisht nga këmbimet e kredive jofunksionale, tregjet e sigurisë të mbështetura në hipotekë dhe derivativa të ngjashme.

Shkurtimisht:

Qëllimet përfundimtare të “Bazel II” janë:

1. Të sigurohet, që alokimet e kapitalit të bankave janë automatikisht më të ndjeshme ndaj rrezikut

2. Kritja e kërkesave për shpalesje të cilat do të lejojnë pjesëmarrësve të tregut të vlerësojnë mjaftueshmërinë e kapitalit të një institucioni duke luajtur në tregjet financiare

3. Të sigurohet se rreziku (klasik) kreditor, rreziqet e reja operacionale të përcaktuara dhe të gjitha rreziqet e tjera të tregut të jenë të kuantifikuara bazuar në të dhënat dhe teknikat formale;

4. Dhe përfundimisht: Përpyekjet për të lidhur ngusht kapitalin ekonomik dhe rregullatorin e kapitalit për të zvogëluar hapësirën për arbitrazh rregullativ (duke mos harruar globalizimin!). 1)

Një gamë e gjerë e mbikëqyrjes: Tre shtyllat

Që prej zbatimit të tij në dekadën e fundit në vendet e OECD (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik), "Bazel II" i diskutuar më lartë përdor një të ashtu-quajtur koncept të "tri shtyllave" - që do të thotë:

(1) Kërkesat e reja dhe të zgjeruara kapitale (standartet minimale kuantitative),

(2) proceset e rishikimit mbikëqyrës (SRP) dhe

(3) disiplina dhe transparenca e tregut (të dyjat, (2) + (3), standarte kualitative).

### Por çfarë kuptimi kanë këto tri "tema" në përgjithësi?

Shtylla e parë i referohet aspekteve "klasike" kualitative mbikëqyrëse dhe kjo shtyllë ka të bëjë me mirëmbajtjen e kapitalit rregullator për të llogaritur tre komponentët kryesor të rrezikut me të cilat një bankë përballet: rrezikun e mirënjohur të kredisë, dhe rreziku shumë herë i përcaktuar operacional dhe disa rreziqe të tjera të tregut. Rreziqet e tjera nuk konsiderohen plotësisht të kuantifikueshme në këtë fazë.

Pra, përveç kapitalit të njohur TIER I (që do të thotë, përafërsisht, kapitali aksionar të paguar dhe rezervat e drejtpërdrejta), përveç kësaj një zonë e gjerë e TIER II me një skemë të vështirë të llogaritjes.

Komponenti i rrezikut të kredisë mund të llogaritet në tri mënyra të ndryshme në shkallë të ndryshme të sofistikut, përkatësisht qasja (e lehtë) e standardizuar, Qasja Bazuar në Vlerësimin e Brendshëm Themelore (IRB) dhe IRB e Avancuar.

Për rrezikun e përcaktuar të sotëm operativ, janë tri qasje të ndryshme – qasja bazike indikative (BIA), qasja e standardizuar (TSA) dhe qasja përmes matjes së brendshme (një formë e avancuar e cila është qasja e avancuar e matjes (AMA)).

Dhe të mos harrojmë: Për rrezikun e tregut emri i metodës korresponduese është vlera në rrezik (VnR). 3)

Përderisa rekomandimet "Bazel II" janë ndarë në faza të vendet e OECD në industrinë bankare, ato kanë lëvizur nga kërkesat e standardizuara në kërkesa më të rafinuara dhe specifike që janë zhvilluar për çdo kategori të rrezikut nga çdo bankë individualisht. Avantazhi për bankat që zhvillojnë sistemet e tyre të matjes së rrezikut është se ata do të shpërblehen me potencialisht kërkesat më të ulëta të rrezikut të kapitalit. Sipas "Bazel II" tani ka lidhje më të ngushta ndërmjet koncepteve të kapitalit ekonomik dhe rregullator. 1)

### Por a i ka përmbushur të gjitha dëshirat dhe nevojat shtylla e parë e "Bazel II" me të vërtetë?

Përgjigja pas krizës financiare është e thjeshtë: "Jo!". Roli i "Bazel II", si para ashtu dhe pas të ashtuquajturës katastrofës globale, është diskutuar gjerësisht. Përderisa disa argumentojnë se kriza i ka shfaqur dobësitë e kornizës, 4) të tjerët kanë kritikuar atë për faktin që ka rritur efektin e krizës. Si përgjigje ndaj kësaj krize financiare 5), Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare publikoi shpejt standartet globale të amandamentuara. Komiteti në Bazel pohoi, se standartet e reja do të çojnë drejt përmirësimit të cilësisë së kapitalit, rritjes së mbulimit të rrezikut për aktivitetet e tregut të kapitalit dhe standardeve më të mira likuiditeti në mesin e përfitime të tjera. 6)

Përgjithsisht, shtylla e parë e kësaj marrëveshje nuk ishte direkt përgjegjëse për krizat, por promovoi në mënyrë efektive krizat me efektet e saja pro-ciklike. Përveç kësaj, elementet e TIER II kapitalit janë sipas përvojave të vështira nga tendencat e tij të paqëndrueshme dhe në disa raste shumë spekulative. Është e rekomandueshme, që kur të mësojmë nga kriza, të fokusohemi me të vërtetë në një cilësi më të mirë të kapitalit rregullator dhe një menaxhim më të mirë të likuiditetit dhe të mbikëqyrjes. Pra: ka nevojë

urgjente për TIER I kapital shtesë, më pak TIER II kapital dhe - në rastin ideal: me përkufizime të kapitalit bankar më të lehta. Vendet, të cilat sot kanë vetëm një kërkesë minimale prej 12% ose thjeshtë kapital rregullator TIER I nuk duhet të ndryshojnë këtë. 7)

Por, sic dihet, marrëveshja "Bazel II" përmban dy shtylla të tjera interesante:

Një botë e re mbikëqyrëse: një aspekt kualitativ.

Të gjitha këto aspekte janë, aspekte kuantitative me bazë mbikëqyrëse në një mënyrë shumë komplekse. Të rehat në botën e "Bazel II", janë edhe disa mjete kualitative me bazë mbikëqyrëse, mishëruar në shtyllën e dytë të kësaj kornize. Pra, ajo gjithashtu ofron një kornizë nga zbatimi në vendet OECD për të trajtuar riskun sistemik, riskun e pensioneve, riskun e përqendrimit, riskun strategjik, riskun e reputacionit dhe riskun ligjor, që kjo marrëveshje e dytë kombinon me titullin e rrezikut të mbetur. Institucionet kredihënëse mund të shqyrtojnë sistemin e tyre të menaxhimit të riskut. 2)

Kërkesat e parashtruara në këtë shtyllë kanë të bëjnë me menaxhimin e risqeve materiale të institucionit, si dhe përqendrimet e riskut që lidhen me këto risqe. Për të vlerësuar nëse një risk konsiderohet material, menaxhmenti duhet të marrë një pasqyrë të profilit të përgjithshëm të riskut të institucionit.

Si rregull i përgjithshëm, llojet e riskut që të merren në konsideratë përfshijnë:

- a) risqet nga pala tjetër (duke përfshirë risqet e vendit),
- b) risqet e çmimeve të tregut,
- c) risqet e likuiditetit dhe
- d) risqet operacionale.

Vendimet për kredihënje në kuptimin e kësaj shtylle përfshijnë të gjitha vendimet për kreditë e reja, rritjet e kredive, normat pjesëmarrëse të interesit, tejkalimi i limiteve, përcaktimi i limiteve për huamarrësit, si dhe limitet për palët tjera dhe huadhënësit, përzgjatja dhe ndryshimi në rrethana me rrezikun përkatës mbi të cilat është bazuar vendimi i kreditimit (p.sh. kolateral, qëllimi i kredisë). Çështja nëse vendimi është marrë nga institucioni i vetëm apo së bashku me institucionet e tjera (kreditimit i sindikuar) është jomaterial.

Përgjithësisht, "tema" biznesi tregëtarë mbulon të gjitha aktivitetet në bazë të një:

- a) transaksioni i tregut të parasë,
- b) transaksioni i letrave me vlerë,
- c) transaksioni i këmbimit valutor,
- d) transaksioni i të arkëtueshmeve të zëvendësueshme (p.sh. tregtia me huamarrësit).
- e) transaksioni i mallrave
- f) transaksioni i derivativeve,

dhe të cilat konkludohen në emër të institucionit dhe për llogari të vet. Transaksionet e letrave me vlerë përfshijë edhe transaksionet me bonot e regjistruara dhe kreditimin e letrave me vlerë, por jo lëshimi inicial i letrave me vlerë. Transaksionet tregtare përfshijnë edhe - pa marrë parasysh çfarëdo forme të marrëveshjes së riblerjes.

Varësisht nga natyra, shkalla, kompleksiteti dhe përmbajtja e riskut të aktiviteteve të biznesit, çdo institucion duhet të:

- a) të përcaktoj rregulloret në lidhje me strukturën organizative dhe operative dhe
- b) të vendos procese për identifikimin, vlerësimin, trajtimin, monitorimin dhe komunikimin e riskut.

Gjatë përcaktimit të strukturës organizative dhe operacionale, institucioni duhet të sigurojë që aktivitetet jokompatibile të kryhen nga punonjës të ndryshëm.

Proceset, si dhe detyrat e lidhura me to, kompetencat, përgjegjësitë, kontrollet dhe kanalet e komunikimit duhet të jenë të përcaktuara qartë dhe të përshtatura me njëra-tjetrën. Kjo vlen edhe për lidhjen me kontraktimin material nga jashtë.

Institucioni duhet të vendosë procese të duhura të cilat sigurojnë se risqet materiale mund të:

- a) identifikohen,
- b) vlerësohen,
- c) trajtohen dhe
- d) monitorohen dhe komunikohen,

nga subjektet mbikëqyrëse. Këto procese duhet të përfshihen në një sistem të integruar të menaxhimit të kthimit të riskut.

Çdo institucion kreditor duhet të ketë një auditim të brendshëm të mirëfilltë. Funkcionet e auditimit të brendshëm mund të kryhen nga një anëtar i bordit menaxhues nëse do të ishte joproporcionale në lidhje me madhësinë e institucionit të krijohet një auditim i brendshëm. Dorëheqjet në këtë kontekst janë të rekomandueshme.

Auditimit të brendshëm si një instrument i bordit menaxhues është nën kontrollin e tij të drejtpërdrejtë dhe raporton te bordi menaxhues. Gjithashtu mund të jetë subjekt i kontrollit të drejtpërdrejtë nga një ekzekutiv në bordin menaxhues, i cili duhet, nëse është e mundur, të jetë kryesuesi. 8)

Në kombinim të drejtpërdrejtë me këtë, ka pjesë të "detyrave të shtëpisë" për të dyja palët: nga njëra anë kemi Procesin e Vlerësimit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit të Brendshëm (ICAAP) që është rezultat i Shtyllës II të marrëveshjes "Bazel II", të cilën bankat e mbikëqyrura duhet të përmbushin në mënyrë të kualifikuar. Nga ana tjetër, në kontekstin e "detyrave të shtëpisë" kemi Rishikimin Mbikëqyrës dhe Procesin e Vlerësimit (SREP), i cili duhet të realizohet nga ana e mbikëqyrësve bankar. 9)

Si mësim nga kriza, duhet të informojmë publikun, se idetë e shtyllës së dytë kanë qenë dhe janë shumë të dobishme dhe thjeshtë të mira. Nuk është për t'u habitur që ato kanë mbijetuar në marrëveshjen e tretë të Bazelit. 7)

### **Le të kemi një qeverisje të mirë korporative në botën ekonomike**

Shtylla e tretë ka për qëllim të plotësojë kërkesat minimale të kapitalit dhe procesin e rishikimit mbikëqyrës duke zhvilluar një sërë kërkesash për shpalosje informatash të cilat do të lejojë pjesëmarrësit e tregut të vlerësojnë mjaftueshmërinë e kapitalit të një institucioni.

Aspekti kryesor në këtë kontekst është disiplina e tregut, shtojcat e rregullores si shkëmbim të informacionit që lehtësojnë vlerësimin e bankës nga të tjerët, duke përfshirë investitorët, analistët, konsumatorët individual, bankat e tjera, dhe agjensitë e vlerësimit, e cila çon në një qeverisje të mirë të korporatave. Qëllimi i kësaj shtylle të tretë është që të lejojë disiplinën e tregut të operojnë duke kërkuar nga institucionet të bëjnë të ditur detaje mbi qëllimin e aplikim-

it, kapitalin, ekspozimi ndaj riskut, proceset e vlerësimit të riskut, dhe mjaftueshmëria e kapitalit të institucionit. Duhet të jetë në përputhje me atë që menaxhmenti i lartë, duke përfshirë bordin, vlerëson dhe menaxhon risqet e institucionit.

Kur pjesëmarrësit e tregut kanë një kuptim të mjaftueshëm të aktiviteteve të një banke dhe kontroleve që ajo ka për të menaxhuar ekspozimet e saj, ata janë më të aftë të bëjnë dallimin midis organizatave bankare në mënyrë që ata të mund të shpërblejnë ata që menaxhojnë risqet e tyre me maturi dhe të penalizojnë ata që nuk bëjnë.

Këto shpalosje janë të nevojshme që të bëhen të paktën dy herë në vit, me përjashtim të shpalosjeve kualitative që ofrojnë një përmbledhje të objektivave të përgjithshme të menaxhimit të riskut dhe politikave të cilat mund të bëhen çdo vit. Institucionet gjithashtu duhet të krijojnë një politikë zyrtare mbi atë që do të shpalosen dhe kontrollet rreth tyre së bashku me vlefshmërinë dhe frekuencën e këtyre shpalosjeve. Në përgjithësi, shpalosjet nën shtyllën e tretë zbatohen në nivel të lartë të konsolidimit të grupit bankar në të cilën vlen korniza "Bazel II".

Ne mund të mësojmë nga kriza globale, se idetë e shtyllës së tretë ishin udhëheqëse të targeteve dhe me të vërtetë shumë të frytshme. Një qeverisje e mirë korporative, e ngulitur thellë në sistemin bankar rajonal Gjerman, është mbrojtja më e mirë kundër kolapsimeve bankare në raste të tregjeve financiare jostabile. 7)

### **Bazel II në të ardhmen?**

Një nga aspektet më të vështira të zbatimit të "Bazel II" është nevoja për të akomoduar kultura të ndryshme, modele strukturore të ndryshme, kompleksitetet e politikave publike, dhe rregullore ekzistuese. Çdo vend ka zhvillimin e tij individual.

Përveç kësaj, menaxhmenti i lartë i bankave do të përcaktojë strategjinë korporative, si dhe vendin në të cilin do të bazojnë një biznes të llojit të caktuar, bazuar pjesërisht në mënyrën se si "Bazel II" interpretohet nga legjislaturat dhe rregullatorët e vendeve të ndryshme. Ekziston gjithashtu nevoja për të ndihmuar institucionet kreditore sa më shpejt që të jetë e mundur që të veprojnë me kërkesa të shumta të raportimit për rregullatorë

të ndryshëm sipas vendndodhjes gjeografike; ka disa aplikacione softuerike në dispozicion. Këto përfshijnë makina llogaritëse të kapitalit dhe shtrihen deri në zgjidhjet e automatizuara të raportimit të cilat përfshijnë raportet e kërkuara. Si një mjet komunikimi, shoqatat bankare do të jenë shumë të dobishme. 1)

Duhet të thuhet se rregullat bankare të bazuara në marrëveshjen Bazel II inkurajojnë praktikat jo të zakonshme të biznesit dhe kontribuojnë apo edhe përforcojnë goditjet negative sistemike që u materializuan gjatë krizës financiare. Sipas kësaj, rregullat e kapitalit të bazuara në asete të matura kundrejt riskut inkurajojnë inovacione të projektuara për të anashkaluar kërkesat rregullative dhe zhvendosin fokusin e bankave larg funksioneve të tyre themelore ekonomike. Kërkesat më strikte të kapitalit të bazuara në asete të matura kundrejt riskut, mund të kontribuojnë më tej në këta stimuj të keq-drejtuar. Rregullorja e re për likuiditetin, pavarësisht qëllimeve të saj të mira, është një tjetër kandidat i mundshëm për të rritur stimujt e bankave për të shfrytëzuar rregulloren. Duhet rekomanduar, se vendet me një kërkesë minimale të përcaktuar lehtë për TIER I kapital nuk duhet të ndryshojnë këtë në të ardhmen. 11)

Kur të shikojmë tani shtyllat 2 dhe 3 të "Bazel II", mund të ketë, në të kundërt me shtyllën 1, shumë aspekte të mbikëqyrjes udhëheqëse të targeteve. Në çdo rast, në kohën e përgatitjeve dhe të realizimit duhet të ketë një dialog të thellë në mes të mbikëqyrësit dhe të mbikëqyrurit në mënyrë që të jenë të suksesshëm në fund të ditës!

#### Referencat:

1. Annual Report of BaFin 2006: "Bazel II", p. 130 f, Bonn and Frankfurt/ M., 2007
2. Annual Report of Federal Financial Supervisory Authority (BaFin) 2004: "Bazel II", p. 48 f, Bonn and Frankfurt/ M., 2005
3. BaFin, Circular: "Minimum Requirements for Risk Management", Bonn and Frankfurt/ M., 21 December 2009 (Circular 22/ 2009 (BA))
4. Bloomberg Business week Magazine: "How New Global Banking Rules Could Deepen the U.S. Crisis", New York, 16.04.2008
5. Council of Mortgage Lenders: "Bazel II - Questions and Answers", London, 2013
6. Canstar, Justine Davis: "The Credit Crunch", Brisbane, 11.04.2014
7. Daniel Sigrist, in: Die Volksirtschaft: "Hat Bazel II versagt?", Bern, 12/ 2008
8. Deutsche Bundesbank: "Risk-oriented Supervision following Implementation of Pillar II of Bazel II", p. 2 ff, Frankfurt/ M., 27.08.2009
9. Ernst & Young: "New Bazel Capital Accord", p. 20, Frankfurt/ M., September 2002
10. OECD Library: "Systemically Important Banks and Capital Regulation Challenges", Paris, 11.12.2012
11. Wikipedia, the free encyclopedia, information to the keyword: "„Bazel II“"

*Autori është i punësuar në Federatën Gjermane të Autoritetit Financiar Mbikëqyrës (BaFin) dhe reflekton këtë temë vetëm në bazë të opinionit të tij. Ky nuk është automatikisht pozicioni i BaFin apo i ndonjë entiteti tjetër publik Gjerman.*



# Rëndësia në adresimin e çështjeve të sektorit bankar përmes Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të vendit

Një nga strukturat më të rëndësishme në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) është funksionimi i dhjetë (10) grupeve punuese/komiteteve përmes së cilave diskutohen dhe trajtohen çështje me interes për sektorin bankar në Kosovë. Përmes komiteteve, adresohen shumë çështje dhe sfida me të cilat ballafaqohet ky sektor, me ç'rast synohet të bëhet sensibilizimi i opinionit të gjerë, veçanërisht institucionet kompetente të vendit sikurse që është Banka Qendrore, Ministria e Financave, Njësia e Inteligjencës Financiare, Fondi për Sigurimin e Depozitave dhe institucione tjera me interes. Krahas adresimit të çështjeve me interes për këtë sektor, Shoqata e Bankave të Kosovës ka arritë që të jetë pjesë përbërëse e grupeve punuese institucionale apo edhe atyre ndërkombëtare, përmes secilave është bërë hartimi i shumë ligjeve primare dhe sekondare, me ç'rast me ekspertizën e saj ka dhënë kontributin në fushën e sektorit financiar. Në këtë mënyrë, duke pas në konsideratë rëndësinë e sektorit financiar dhe atij bankar në veçanti, Shoqata e Bankave të Kosovës ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit.

Dhjetë komitetet funksionale në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës janë: Komiteti i Pagesave, Thesarit, Ligjor, Burime Njerëzore, Kundër Shpëlarjes me Para, Kundër Mashtrimeve me Kartela, Financave, Sigurisë, Riskut dhe Komiteti i Marketingut.

Ambienti i të bërit biznes në Kosovë vazhdon të paraqet shumë vështirësi për bizneset, veçanërisht në fushën e zbatimit të ligjeve, andaj edhe sektori bankar në këtë mes, është ballafaquar vazhdimisht me këto vështirësi. Shoqata e Bankave të Kosovës, përmes kësaj strukture të rëndësishme në kuadër të saj, në bashkëpunim



**KRESHNIK  
KOSUMI**

ZYRTAR PËR POLITIKA  
DHE STATISTIKA

SHOQATA E  
BANKAVE TË  
KOSOVËS

me institucionet e vendit ka trajtuar çështje me rëndësi të kësaj fushe duke u bërë kështu edhe promotor i shumë iniciativave në vend. Në këtë mënyrë vazhdon të kontribuoj në eliminimin e barrierave për afarizmin bankar në vend, në mënyrë që ky sektor të ofroj kushte më të mira për qytetarët e Republikës së Kosovës. Në vijim të këtij shkrimi po shënojmë disa nga çështjet me interes në të cilat Shoqata e Bankave të Kosovës ka qenë pjesëmarrësve aktive gjatë vitit 2014:

- FATCA (Foreign Account Tax Compliance Act/ Ligji i Pajtueshmërisë mbi Tatimin e Llogarive të Jashtme) - Shoqata e Bankave të Kosovës ka arritë të sensibilizoj në rradhë të parë institucionet e vendit për rëndësinë e implementimit të FATCA-së, direktivë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila ka për qëllim identifikimin e shtetasve amerikan të cilët veprimarinë e tyre e zhvillojnë nëpër vende të ndryshme të botës, me këtë rast në Kosovë. Mos implementimi i saj, do të kishte pasoja për sektorin bankar në Kosovë për shkak të mos përshtatjes/bashkëpunimit të këtij sektori me kërkesat që vijnë nga jashtë. Tani më kjo çështje është në fazën

përfundimtare të implementimit të saj dhe Kosova është në prag të nënshkrimit të marrëveshjes ndërshtetërore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës;

- Rregullorja për Kredi Hipotekare – SHBK në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës dhe Zyrën e Thesarit Amerikan kanë krijuar një grup punues përmes secilës kanë bërë hartimin e kësaj rregulloreje e cila ka për qëllim që të ndihmoj dhe lehtësoj qytetarët dhe bankat në procesin e kreditimit hipotekarë. Hartimi i rregullores është në fazën përfundimtare të saj;
- Përmbauesit Privat – SHBK ka qenë e përfshirë në shumë prej aktiviteteve që kanë të bëjnë që nga hartimi i udhëzimeve mbi bazën e të cilës do të punojnë përmbauesit privat dhe deri tek licencimi i tyre. Fillimi i punës së këtyre përmbauesve gjatë muajit maj 2014, ka qenë një sukses i të gjitha institucioneve në vend, ngase besohet që këta do të ndihmojnë shumë sistemin gjyqësorë të Kosovës, për shkak të ngulfatjes së tyre më lënd të cilat ende nuk janë zgjidhë. Puna e tyre do të ndihmon shumë edhe sektorin bankar, ngase siç dihet në sistemin gjyqësorë tani më ekzistojnë mbi 10,000 lëndë gjyqësore që presin të trajtohen vetëm nga sektori bankar;
- Memorandumi i Mirëkuptimit me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Ky memorandum i lidhur ndërmjet bankave afariste dhe Departamentit për Pensione në kuadër të MPMS-së, ka për qëllim pagesën e skemave pensionale dhe ato sociale përmes llogarisë bankare. Me këtë rast SHBK ka ngritë për diskutim me përfaqësuesit e MPMS-së për të mundësuar që edhe për këto kategori të shoqërisë të ju mundësohet lëshimi i kartelave bankare, meqenëse marrëveshja aktuale nuk e lejon një gjë të tillë. MPMS ka hartuar një verzion të ri të kësaj marrëveshjeje dhe është në fazën e trajtimit të kërkesave të kësaj kategorie shoqërore, por edhe të vet bankave afariste;
- Forumi mbi Sigurinë Bankare – Shoqata e Bankave të Kosovës në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave nga Shqipëria me datë 28 maj 2014, kanë bashkë-organizuar tryezë diskutimi e cila ka mbledhë ekspertë të fushës së sigurisë fizike dhe sigurisë së informacionit.

Një theks i veçantë i është kushtuar zhvillimeve më të reja në fushën e sigurisë bankare dhe në mënyrë të veçantë bashkëpunimit ndërmjet strukturave të sigurisë në bankat afariste dhe institucioneve mbikqyrëse/shtetërore dhe partnerëve të tjerë në Shqipëri dhe Kosovë;

- Rregullorja e letrave me vlerë – me kërkesë të SHBK-së tek Ministria e Financave, përkatësisht Departamenti i Thesarit, ky institucion ka bërë ndryshimin e rregullores së letrave me vlerë, me ç'rast ka ndryshuar metodën e çmimit të shitjes për bonot e thesarit dhe bonot qeveritare, pra ka filluar të aplikohet sistemi me çmim të shumëfishtë. Rregullorja e re ka hyrë në fuqi me datë 10 mars 2014;
- Forumi i Tretë Kombëtar i Kartave – SHBK ka marrë pjesë në Forumin Kombëtar të Kartave të mbajtur me 16 maj 2014 dhe të organizuar nga Shoqata e Bankave nga Shqipëria. Në këtë forum, SHBK është përfaqësuar nga zt. Fisnik Behxheti, me ç'rast ka prezantuar temën "Zhvillimet e Sektorit të Kartave në Kosovë", me ç'rast është bërë shkëmbimi i njohurive dhe përvojave nga të dy vendet tona;
- Komentimi i draft rregulloreve dhe udhëzimeve – Shoqata e Bankave të Kosovës gjatë vitit 2014 ka dhënë kontributin e saj përmes dhënies së sugjerimeve dhe komenteve në funksion të interesit të këtij sektori, por edhe në funksion të interesit të përgjithshëm të qytetarëve. Ne vijim po i shënojmë disa nga rregulloret dhe udhëzimet në të cilat SHBK ka marrë pjesë: rregullorja për kredi hipotekare, rregullorja për kamatvonesën, rregullorja e letrave me vlerë, rregullorja për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimi i terrorizmit, udhëzimi për tarifa të përmbauesve privat, udhëzimi për personat e ekspozuar politikisht, udhëzimi për operim me skemën e pagesave Kos-Giro dhe Debitim Direkt;

Shoqata e Bankave të Kosovës gjatë gjithë kësaj kohe ka ndërtuar bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha institucionet në vend, duke vlerësuar se vetëm bashkërisht dhe përmes një bashkëpunimi të ngushtë dhe të mirëfilltë mund të arrihen rezultate të rëndësishme në interes të të gjithëve.



## Terme financiare që duhet ditur

**Përkufizimi i pikë përqindjes:** Dallimi në mes të dy përqindjeve quhet si pikë përqindjeje. Pikë përqindja përdoret për të treguar ndryshimet në një tregues në lidhje me qëndrimin e saj të mëparshëm.

**Vlera neto kontabël e një pasurie të paluajtshme:** Kostoja origjinale e artikullit minus zhvlerësimi i akumuluar i artikullit.

**Vlera bruto kontabël e pasurive të paluajtshme:** Vlera bruto kontabël është çmimi origjinal /historik i paguar për një pasuri, pa zbritur zhvlerësimin.

**Të hyrat e shtyra:** Të ardhurat e shtyra (të njohura edhe si të hyrat e shtyra, të ardhurat e pafituara, apo të hyrat e pafituara) janë, në kontabilitetin aktual, paratë e pranuar për mallrat ose shërbimet të cilat nuk janë dorëzuar ende. Sipas parimit të njohjes së të ardhurave, ato duhet të regjistrohen si detyrime derisa dorëzimi të është bërë, kohë në të cilën kthehen në të ardhura.

**Përkufizimi i kontabilitetit aktual:** Një metodë kontabël që matë punën dhe pozicionin e një kompanie me njohjen e ngjarjeve ekonomike pavarësisht kohës kur transaksionet në para të gatshme ndodhin. Ideja e përgjithshme është se ngjarjet ekonomike njihen nëpërmjet përputhjes së të ardhurave me shpenzimet (parimi i përputhjes) në kohën kur transaksioni ndodh dhe jo në momentin e pagesës (ose pranimit). Kjo metodë lejon flukset monetare hyrëse /dalëse aktuale të kombinohen me flukset monetare hyrëse /dalëse të pritshme në të ardhmen për të dhënë një pasqyrë më të saktë të gjendjes aktuale financiare të kompanisë.

**Vlera nominale:** Vlera e deklaruar e një letre me vlerë të lëshuar. Vlera nominale në ekonomi gjithashtu i referohet një vlere të shprehur në terma monetare për një vit apo vite specifike, pa u përshtatur për inflacionin. Kur përdoret në lidhje me letrat me vlerë, vlera nominale njihet edhe si par vlerë.

**Paraja e imët (Petty Cash):** Një fond i vogël i parave të gatshme të mbajtura në dorë për blerjet ose rimbursimet shumë të vogla në vlerë që të paraqiten me procedurat më rigorozë të blerjes dhe të rimbursimit të një kompanie apo institucioni. Fondet monetare të vogla duhet të mbrohen

dhe të dokumentohen për tu siguruar që vjedhjet nuk ndodhin. Shpesh një kujdestar për fondet emërohet si përgjegjës për ndonjë deficit apo mungesë dokumentacioni të parase së gatshme.

**Përkufizimi i paangazhimit:** Një pasuri ose pronë që është e lirë dhe e pastër nga çdo angazhim të tillë si kërkesat e kreditorëve ose obligime tjera. Një pasuri e paangazhuar është shumë më e lehtë për tu shitur apo transferuar sesa ajo e angazhuar. Shembuj të pasurive tipike të paangazhuara janë shtëpitë që nuk janë nën hipotekë ose nën ndonjë obligim tjetër, një makinë ku kredia e automobilave është paguar, ose stoqe të blera me llogari të parave të gatshme, në vend të llogarive rezervë.


**Diversifikimi:** Mosvënia e të gjitha vezëve në një shportë. Investitorët janë të inkurajuar të bëjnë këtë përmes teorisë moderne të portofolios, pasi që mbajtja e disa aksioneve të ndryshme dhe pasurive tjera ndihmon në zvogëlimin e rrezikut. Në fund të ditës, megjithatë, diversifikimi është disi jashtë modës. Studimet ekonomike për korporatat e bashkuara të diversifikuara kanë identifikuar se këto shpesh kanë lënduar aksionarët e firmës blerëse; në të kundërt, firmat e larmishme që kanë shitur bizneset jo-thelbësore, në shumicën e rasteve iu kanë shkaktuar përfitime aksionerëve të tyre.

**Dampingu:** Shitja e një artikulli më lirë se kostoja e prodhimit të tij. Kjo mund të përdoret nga një kompani dominante për të sulmuar rivalët, një strategji të njohur nga autoritetet e mosbesimit si çmimet grabitqare. Pjesëmarrësit në tregtinë ndërkombëtare janë akuzuar shpesh për damping nga kompanitë vendore për ngarkim më të lartë çmimesh se importet rivale. Shtetet mund të vendosin taksa mbi importet të lira që ata gjykojnë se janë dampingje në tregjet e tyre. Shpesh kjo quhet si proteksionizëm i maskuar hollë kundër firmave të huaja më efikase. Në praktikë, çmimet grabitqare të vërteta janë të rralla - sigurisht shumë më rralla se veprimet anti-damping - për shkak se ajo mbështetet në aftësinë e vështirë të një prodhuesi të vetëm për të dominuar një treg botëror. Në çdo rast, konsumatorët fitojnë nga çmimet më të ulëta; sikurse kompanitë që blejnë furnizimet e tyre më të lira jashtë vendit.


**Referencë:** <http://www.economist.com/economics-a-to-z> (data e qasjes: 15/06/14)

## Një listë verore leximi për bankierët


**1. Shpëtimi: Si shikova Washington-in duke shpëtuar Wall Street-in ndërsa braktiste Main Street-in”, nga Neil Barofsky:** “Perspektiva e brendshme e mallkuar e Barofsky-t se si zyrtarët e Qeverisë trajtuan krizën financiare të 2008 ka gjeneruar një gumëzhimë të madhe...dhe kritika. New York Times ndau mendimin edhe me recensuesin duke e quajtur librin një ‘duhet-lexuar’ edhe me një tjetër që pohoi se narrativa në veten e parë e ish Inspektorit Special të Përgjithshëm të Programit për Lehtësimin e Pasurive të Trazuara (TARP) përbante ‘kontradikta dhe mospërputhje’ të shumta. Komentet e përziera ofrojnë edhe më shumë nxitje për të lexuar librin e fundit mbi shpëtimin pasi që detyron lexuesit të nxjerrin konkluzionet e tyre vetanake”.




**2. “Financat dhe Shoqëria e Mirë,” nga Robert J. Shiller:** Në këtë libër të rëndësishëm dhe të kohës, Shiller argumenton se, në vend se të dënojmë financat, ne duhet ti përmirësojmë ato për të mirën e përbashkët. Ai bën një rast të fuqishëm për pranimin se financat, larg të qenit një parazit në shoqëri, janë një nga mjetet më të fuqishme që kemi për zgjidhjen e problemeve tona të përbashkëta dhe rritjen e mirëqenies së përgjithshme. Ne kemi nevojë për më shumë risi financiare - jo më pak - dhe financat duhet të luajnë një rol më të madh për të ndihmuar shoqërinë në arritjen e qëllimeve të saj.




**3. “Paraja Zbavitëse,” nga Mark Singer:** Duke rrëfyer gjithë historinë e saj spektakolare dhe karakteret piktoreske, Singer bën të qartë në mënyrë të shkëlqyeshme (dhe gazmore) se çfarë në të vërtetë ka ndodhur dhe pse ajo duhej të ndodhte në kohën e lulëzimit në Oklahoma. Rrjedha e parasë nuk ishte aq spontane në asnjë vend tjetër. “[Një] përrallë me entuziazëm të mrekullueshëm” (New York Times), Paraja Zbavitëse vjen në jetë me anë të prozës së gjallë të Singer-it dhe vazhdon të rezonon në kulturën e sotme të korrupsionit të korporatave.



**4. “Privilegj i tepruar: Ngritja dhe rënia e dollarit dhe e ardhmja e Sistemit Monetar Ndërkombëtar,” nga Barry Eichengreen:** Në Privilegj-in e Tepruar, një nga ekonomistët tanë të shquar, Barry Eichengreen, gjurmon rritjen e dollarit me rëndësi ndërkombëtare në rrjedhën e shekullit të 20. Ai tregon se si dollari dominoi ndërkombëtarisht në gjysmën e dytë të shekullit për të njëjtat arsye - dhe në të njëjtën mënyrë - si Shtetet e Bashkuara që dominuan ekonominë globale. Por tani, me rritjen e Kinës, Indisë, Brazilit dhe ekonomive tjera në zhvillim, Amerika nuk ngritet mbi ekonominë globale. Vijimi, Eichengreen argumenton, i dollarit nuk do të jetë aq dominues. Por kjo nuk do të thotë se ndryshimet do të vijnë domosdoshmërisht dhe se do të jenë të papritura dhe të tmerrshme - ose se dollari është i dënuar të humb statusin e tij ndërkombëtar.



**5. “Shtëpia e Morgan-ëve: Një Dinasti Amerikane Bankare dhe Ngritja e Financave Moderne,” nga Ron Chernow:** Fituesi i Çmimit Kombëtar të Librit që tani konsiderohet si një klasik, Shtëpia e Morgan-ëve është historia më ambicioze e shkruar ndonjëherë për dinastinë bankare Amerikane. Vlerësuar nga The Wall Street Journal si “e shkruar dhe hulumtuar shkëlqyeshëm”, libri tregon një histori të pasur dhe panoramike të katër brezave të Morganëve dhe të firmave të fuqishme dhe të fshehta që ata krijuan. Kjo është llogaria definitive e ngritjes së botës moderne financiare. Një histori e flaktë bankare me lulëzimet dhe falimentimet që i dhanë formë botës në të dy anët e Atlantikut, Shtëpia e Morgan-ëve gjurmon trajektorën e perandorisë së JP Morgan nga fillimet e saj të errëta në Londrën Viktoriane deri në rrëzimin e 1987-ës. Ron Chernow pikturon një portret fasciues të sagës private të Morgan-ëve dhe botës të rralluar të elitës Amerikane dhe Britanike në të cilën ata u zhvendosën.








**6. "Rrëmuja e Megabankave," nga Herb Allison:** Herb Allison ndërton një rast të fuqishëm për të thyer megabankat dhe rregullat e rishikuara dhe mbikëqyrjen e industrisë financiare në mënyrë që interesi publik të mund të mbizotërojë mbi vetë-interesin e bankierëve dhe...një tjetër krizë financiare të mund të shmanget.

**7. "Krediti Praktik i Bankës", nga Herbert Prochnow i Bankës Kom-bëtare Kontinental në Illinois.**

**8. "Fundit Parave: Falsifikimet, Predikuesit, të Pasionuarit e Teknologjisë, Ëndërrimtarët - dhe Shoqëria e Ardhshme pa Para të Gatshme", nga David Wolman:** Me vite, paratë kanë pasur kuptimin e disqeve të vogla metalike dhe drejtkëndëshëve të letrës. Por dobia e parave fizike - për të mos përmendur vlerën e saj - po vihet nën zjarr si kurrë më parë. Intriguar nga mundësia e qartë se paratë së shpejti do të zhduken, autori dhe redaktori i lidhur kontribues David Wolman vendos të hetojë të ardhmen e parave...dhe si do të ndikojë në portofolin tuaj.

**9. "Ekonomia e Synimit: Kur Konsumatorët marrin kontrollin", nga Doc Searls:** Përderisa tregëtarët kërkojnë më tepër rrugë për tu bërë më personal me klientët, duke përfshirë truqe të reja me "të dhëna të mëdha," klientët janë duke u bërë më personal në mënyrat e tyre, me mjetet e tyre. Së shpejti konsumatorët do të jenë në gjendje të: (1) të kontrollojnë rrjedhën dhe përdorimin e të dhënave personale, (2) të ndërtojnë programet e veta të besnikërisë, (3) të diktojnë kushtet e tyre të shërbimit, dhe (4) ti tregojnë tregjeve të tëra për ato që duan, si ata i duan, ku dhe kur ato duhet të jenë në gjendje për tu marrë, dhe sa duhet të kushtojnë. Dhe ata do të bëjnë gjithë këtë jashtë premisave të çdo shitësi. Ky peisazh i ri në të cilin ne jemi duke hyrë është ajo çfarë Doc Searls quan "Ekonomia e Synimit" - në të cilën kërkesa do të drejtojë furnizimin në mënyrë më të drejtpërdrejtë, efikase, dhe imponuese se kurrë më parë. Në këtë libër ai përshkruan një ekonomi të drejtuar nga qëllimi i konsumatorit, ku shitësit duhet ti përgjigjen qëllimeve aktuale të konsumatorëve në vend se të konkurrojnë për vëmendjen e shumë njerëzve. Mjete të reja të konsumatorëve do të sigurojnë motorin me MMS (Menaxhimi i Marëdhënies me Shitësin) duke siguruar konsumatorin me homologun e shitësit - MMK (Menaxhimi i Marrëdhënies me Konsumatorin)'.  
 10. "Banka e Humbur," nga Kirsten Grind: Gjatë ditëve më konfuzë të krizës financiare, Washington Mutual, një bankë me qindra miliarda dollarë në arkën e saj, pësoi një dëmtim prej largimit nga banka. Historia përfundimtare e rrëzimit të saj brutal në Vjeshtë të vitit 2008, dhe shitja e saj diskutabile në JPMorgan Chase, është një rast i habitshëm se si një bankë ka humbur veten nga lakmia dhe keqmenaxhimi, dhe se si e gjithë industria financiare; dhe madje edhe gjithë vendi; humbën rrugën e tyre.

**11. "Lufta e Valutave: Krijimi i Krizës së Ardhshme Globale," nga James Rickards:** Siç argumenton James Rickards në Luftën e Valutave, kjo është më shumë se vetëm një shqetësim për ekonomistët dhe investitorët. Rickards zgjidh rrjetën e paradigmave të dështuara, mendimeve dëshiruese, dhe arrogancën që drejton politikën publike aktuale dhe tregon rrugën drejt një serie veprimesh më efektive dhe të informuara.



**Referencë:** <http://www.americanbanker.com/gallery/-1051605-1.html> (data e qasjes 15/06/14)

## Java Ndërkombëtare e Parasë në Kosovë



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave të Kosovës (SHBK) organizuan një punëtori me nxënës të shkollave fillore të Prishtinës, klasët e katërta dhe të pesta, ku u prezantua lidhur me kursimet duke përdorur moton "Të mësojmë të kursejmë".

Ky aktivitet u organizua në kuadër të aktiviteteve të Edukimit Financiar me qëllim vetëdijësimin e fëmijëve dhe të rinjve lidhur me financa. Java Ndërkombëtare e Parasë organizohet çdo vit në më shumë se 80 shtete të botës ku synohet edukimi financiar i fëmijëve, nxënësve dhe të rinjve. Këtë vit, për herë të parë edhe Kosova organizon dhe shënon këtë ditë duke iu bashkuar edhe vendeve të rajonit të cilat organizojnë ngjarje të tilla. Fjalë hyrëse në këtë rast pati nga Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), z. Bedri Hamza, ku u theksua rëndësia e kursimeve, si duhet fituar dhe shpenzuar paratë me mençuri dhe si të bëhen fëmijët më të kujdesshëm kur paraqesin dëshirat e tyre tek prindërit. Guvernatori Hamza tregoi disa shembuj përmes të cilëve shpjegoi efektin e kursimeve.

Në anën tjetër, fjalë hyrëse pati edhe nga Kryetari i Bordit Drejtues të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK), z. Robert Wright, ku u prezantua procesi i kursimit përmes të cilit u tha se kursimet që bankat mbledhin pastaj përdoren për të lëshuar kredi tek klientët që kanë nevojë për kredi. Z. Wright inkurajoi fëmijët dhe prindërit për të kursyer në mënyrë që të kenë një të ardhmë më të sigurt. U theksua edhe mënyra se si punojnë bankat dhe rolin që ato kanë në shoqëri. Pas fjalës së z. Wright, znj. Shkëndije Himaj, Këshilltare e Bordit Ekzekutiv në BQK, bëri një prezantim lidhur me kursimet ku u tregoi fëmijëve tregime personale në cilësinë e prindit, theksoi rëndësinë e kursimeve dhe inkurajimin për të kursyer nga prindërit. BQK po ashtu ka ndarë edhe disa dhurata simbolike për fëmijët që ishin prezent në këtë punëtori duke përfshirë këtu edhe kuti të kursimeve, fletore për të bërë fëmijët planin e kursimeve, si dhe u ka shpërndarë një ftesë për të marrë pjesë më punimet e tyre për të demonstruar shkathhtësitë e tyre në vizatime, vjersha apo të ngjashme dhe do të shpërblehen me çmime nga BQK-ja.

14 Mars 2014

## Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) dhe Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) mbështesin programin e edukimit financiar në Kosovë

SHBK si përfaqësuese e sektorit bankar në Kosovë dhe IFC, anëtare e grupit të Bankës Botërore, kanë nënshkruar marrëveshje të përbashkët për përmirësimin e edukimit financiar në Kosovë, duke treguar kështu një përkushtim për edukimin e konsumatorëve. Përmes edukimit financiar, do të ndihmojë në rritjen e aftësive dhe njohurive të klientëve dhe klientëve potencial të bankave në Kosovë mbi bazat e financave.

Me zgjerimin e sektorit financiar dhe njohurinë e ulët financiare të klientëve të cilët kanë filluar të përdorin gjithnjë e më shumë shërbime financiare, vendi ka zhvendos vëmendjen tek mbrojtja e konsumatorit dhe edukimi financiar, duke siguruar në këtë mënyrë që klientët janë duke u trajtuar në mënyrë të drejtë. Mungesa e njohurive mbi marrëdhëniet kontraktuale nga klientët dhe mbi bazat e financave pengojnë zhvillimin e ndërmarrësisë, ekonomive familjare dhe bizneseve të vogla. Gjithashtu është e njohur gjerësisht se kuptimi financiar në mes të klientëve të insitucioneve financiare është i ulët, posaçërisht klientët, ekonomitë familjare dhe NVM-të.

Petrit Balijs, drejtor ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës u shpreh se "Bankat komerciale në Kosovë janë duke marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme në projekte të cilat si qëllim kanë përmirësimin e kushteve socio-ekonomike të qytetarëve të Kosovës. Ky projekt në mes të SHBK dhe IFC është një shembull i mirë i një iniciative të tillë, që ne besojmë se do të ndihmojë në ngritjen e vetëdijes dhe të edukimit për sistemin bankar në vendin tonë".

SHBK si pjesë e strategjisës së saj për edukim financiar, do të mbështesë financiarisht, përderisa IFC do të asistojë SHBK-në në implementimin e Programit për Edukim Financiar, në mënyrë që të përmirësojë nivelin aktual të



edukimit financiar të popullatës, posaçërisht duke targetuar klientët ekzistues dhe potencial të bankave në Kosovë.

Ky program përmban një mori të aktiviteteve, identifikon kanalet më të mira të shpërndarjes dhe siguron konsistencë në mesazhin kryesor të programit në nivel ndërkombëtarë.

Në fazën fillestare të programit, do të zhvillohet një studim i gjerë i edukimit financiar, i cili ka për synim që të mas nivelin aktual i edukimit financiar të popullatës.

Duke u bazuar në rezultatet e studimit, trajnimet dhe konsultimet do të organizohen me qëllim që të rritet edukimi financiar i klientëve ekzistues dhe potencial i bankave. Për më tepër, dizajni dhe zhvillimi i materialeve për marketing për popullatën e gjerë do të bëhet përmes kanaleve të ndryshme të shpërndarjes siç janë televizioni (TV) dhe radio; materialet e printuara dhe përdorimi i teknologjisë së re (SMS dhe/ose mesazhe nga call center). 30 Qershor, 2014

## Shqipëria dhe Kosova takohen në Prizren në Forumin për Sigurinë Bankare



Sot përfundoi punimet Forumi i Tretë Kombëtar Për Sigurinë Bankare, në Prizren. Forumi bashkoi ekspertët nga fusha e sigurisë bankare të cilët në këtë tryezë diskutuan rreth temave aktuale dhe zhvillimeve më të fundit në lëminë e sigurisë, me ç'rast adresoi të dy elementet e sigurisë bankare, pra asaj fizike dhe të informacionit. Për herë të parë, forumi është mbajtur me bashkëorganizim të shoqatave bankare të dy vendeve, Kosovës dhe Shqipërisë. Gjatë forumit, përfaqësues të dy vendeve nga bankat komerciale, bankat qendrore, policia dhe agjencia shtetërore për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe kompani të huaja për ofrimin e zgjidhjeve në lëmin e sigurisë së informacionit, shpalosen brengat dhe zgjidhjet e tyre lidhur me sigurinë fizike dhe atë të informatave.

Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës Petrit Balijs shprehet i kënaqur me

bashkëpunimin që kanë krijuar gjatë vitit të fundit me Shoqatën e Bankave të Shqipërisë (SHBSH) dhe vlerëson se bëhet fjalë për një ngjarje të rëndësishme së veçantë për industrinë bankare. "Si shoqatë e bankave ne mendojmë se siguria fizike, por edhe siguria e informacionit është faktor kyç për klientët e bankave komerciale dhe në këtë drejtim është investuar mjaft shumë nga bankat e Kosovës dhe që ka rezultuar në një sistem shumë të sigurtë financiar në Kosovë. Njëkohësisht, vlerësoj se nevojitet një bashkërendim më i gjerë vendor, por edhe rajonal për të shkëmbyer përvojat në mes të industrive bankare të rajonit dhe njëkohësisht për të përmirësuar komunikimin me institucionet relevante të sigurisë siç është Policia e Kosovës". 28 Maj 2014.

## Shoqata e Bankave të Kosovës takohet me misionin e FMN-së



Në vazhden e takimeve të misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në Kosovë, sot, më datën 27 mars 2014, u mbajt një takim në mes të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) dhe anëtarëve të saj, bankat komerciale në Kosovë, dhe misionit të FMN-së që po viziton Kosovën këto ditë. Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës Z. Petrit Balija, tha se “Në këtë takim u diskutuan çështje me rëndësi për industrinë bankare ku është konkluduar se industria bankare është stabile dhe ka likuiditet të mjaftueshëm por njëkohësisht kemi ngritur shqetësimet tona në lidhje me ngecjet e gjyqësorit në lidhje me trajtimin lëndëve bankare dhe ekzekutimin e kontratave gjë që lidhet me riskun

e lartë në Kosovë ku kemi mbi 10,000 lëndë të papërfunduara”. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) në këtë takim u përfaqësua nga përfaqësuesi rezident i FMN-së për Kosovë, zt. Jose Sulemane, znj. Pamela Madrid, ekonomiste e lartë e Departamentit Evropian, dhe zt. Jacques Miniane, shef i misionit të FMN-së për Kosovën, Departamenti Evropian. Zt. Petrit Balija, shtoi duke thënë se ky takim është mjaft i rëndësishëm për industrinë bankare dhe se takime dhe diskutime të tilla janë gjithnjë të frytshme dhe japin rezultate të mira në të ardhmen. Në këtë takim ishin prezent edhe të gjithë kryeshefët ekzekutiv të bankave komerciale që operojnë në Kosovë, anëtarë të SHBK-së. 27 Mars 2014

## SHBK merr pjesë në kremtë për nder të Ditës Kombëtare të Republikës së Italisë

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balija, me ftesë nga Shkelqesia e tij Ambasadori i Republikës së Italisë z. Andreas Ferrarese, mori pjesë në kremtimin e Ditës Kombëtare të Republikës së Italisë. Me pjesmarrjen e tij z. Balija i shprehu falenderimet e tij për mbështetjen e vazhdueshme nga Republika e Italisë. 3 Qershor 2014



## Banka për Biznes ndihmon të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës



Banka për Biznes, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, SSF dhe IRD, kanë bërë shpërndarjen e 22,800 topave në tërë shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë. Projekti përmbanë tri komponente kryesore, të cilat janë: procesi i shpërndarjes, trajnime edukative si dhe turnire të futbollit. Rreth 800 shkolla dhe 30 organizata rinore, janë shpërblyer me topa, certifikata dhe fanella. Në çdo komunë, drejtorët

e shkollave, drejtorët e arsimit dhe në disa prej tyre edhe kryetari i komunës ishin prezent për të bërë pranimin e këtyre topave. Ne ndihemi të privilegjuar që si bankë vendore kemi ndihmuar qytetarët tanë nëpërmjet sportit dhe aktiviteteve të ndryshme. Kjo ishte një ndër iniciativat që ka ndërmarr banka jonë si përgjegjësi ndaj shoqërisë kosovare. BANKA PËR BIZNES – BANKA E VENDIT TËND! 21 Maj 2014

## BKT në përkrahje të shoqërisë

BKT ka një përgjegjësi të lartë shoqërore që e shpreh theksueshëm me kontributet e saj ndaj shoqërisë Kosovare. BKT mundohet që në mënyrë pozitive të prek jetën e secilit duke e zgjeruar aktivitetin e saj bamirës në fusha të ndryshme të shoqërisë dhe kulturës.

Instrumentet më të rëndësishme të përgjegjëshmërisë sociale të BKT-së janë sponsorizimet, aktivitetet dhe disa vepra bamirësie që reflektojnë vlerat e institucionit ndaj shoqërisë dhe të punësuarve. BKT i kushton një vëmendje të veçantë zhvillimit dhe emancipimit të shoqërisë Kosovare. Përveç projekteve në fushën e mjedisit, sportit, cultures dhe artit në të cilat BKT angazhohet gjerësisht, BKT ka në fokusin e saj edhe aktivitetet që i shtojnë vlera zhvillimit të shoqërisë,



duke u perkujdesur për edukimin dhe arsimin. Në këtë kuadër ajo ka sponsorizuar programe të ndryshme arsimit si dhe ka stimuluar studentët më të mire me bursa studimi.



## Banka TEB vazhdon përkrahjen e tenisit kosovar

Përkushtimi i bankës TEB për të rinjtë e Kosovës vjen si rezultat i përgjegjësisë sociale që ky institucion merr përsipër. Pasi që sporti është aktivitet i shëndetshëm dhe efektiv për trupin dhe trurin e njeriut dhe duke e konsideruar numrin e madh të talentëve në Kosovë, banka TEB vazhdimisht i përkrah edhe tenistët e vendit.

Tashmë, TEB-i është përkrahëse e turneut të tenisit "Dielli TEB Open" për 5 vitet e fundit. Ky turne vitin e kaluar e shënoi edicionin e 13-të, por shtytja e dhënë nga kjo bankë ia ka rritur vlerën dhe profesionalizmin atij. Në këtë turne, garat zhvillohen në dy konkurrenca, në atë individuale dhe të çifteve. Ndër pjesëmarrësit e turneut janë tenistët më të mirë nga ranglista e Kosovës. Këto mbështetje që kjo bankë i bënë janë në pajtim



të plotë me politikat e sponsorimit të TEB - BNP Paribas për t'i ndihmuar lojtarët e rinjë drejt suksesit në fushë, shkollë dhe jetë.

## TEB përkrah basketbollistët e së ardhmes



Banka TEB, tashmë e sa vite, njihet për përkushtimin e saj për rininë kosovare. Kontribuimi në shoqëri dhe në të mirë të komunitetit është pjesë e pandashme e TEB-it, prandaj sponsorimi i evenimenteve sociale, kulturore dhe sportive reflekton një përgjegjësi që kjo bankë e ndien për shoqërinë.

Si pjesë e këtij programi, banka TEB tani e sponsoron basketbollin kosovar, duke pasur ndikim të madh në zhvillimin e këtij sporti në Kosovë. TEB-i është sponsor zyrtar i të gjitha ligave të

gjeneratave të reja në basketboll, e cila është reflektim i vëmendjes që kjo bankë i kushton rinisë, sportit, shëndetit, zhvillimit të karakterit dhe shtytjes për arritje të mëtutjeshme të personave me keso talentesh.

Kjo iniciativë e bankës TEB premtan përkrahje për tri vitet e ardhshme për të gjitha ligat e reja dhe kupat për grupmosha të ndryshme, duke u munduar t'a rrisin numrin e ekipeve dhe profesionalizmin e trajnerëve. 10 Prill 2014

## Banka Raiffeisen donacion në vlerë 100,000 euro për Klinikën Gjinekologjike



Banka Raiffeisen i ka dhuruar Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), përkatësisht Klinikës Gjinekologjike donacion në vlerë 100,000 euro. Donacioni përfshin blerjen e 11 tavolina operative, 10 CTG, 75 shtretër të fëmijëve, 122 dyshek për fëmijë, 385 jastëk për shtretër të nënave, makinë industriale për larje dhe tharje, si dhe materiale shpenzuese.

Kjo shumë është ndarë si donacion nga ana e Bankës Raiffeisen vitin e kaluar kur banka shënoi edhe dhjetë vjetorin e operimit të saj në Kosovë. Mirëqenja sociale, sporti, kultura, edu-

kimi dhe shëndetësia kanë qenë pesë fushat të cilat janë përfshirë në një anketë me klientë ku është kërkuar që klientët të votojnë fushën e cila duhet të përfitojë këtë donacion. Klientët kanë përzgjedhur shëndetësinë dhe më pas Banka ka biseduar me zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë dhe QKUK-së dhe janë përcaktuar që donacioni t'i ofrohet Klinikës Gjinekologjike.

Banka Raiffeisen beson se ky donacion do t'i ndihmojë personelit mjekësor në punën e tyre përditshme dhe do të ndikojë në cilësinë e shërbimeve për nënat kosovare. 22 Maj 2014

## Projektet e përkrahura nga banka Raiffeisen



Përkushtimi i bankës Raiffeisen për të përkrahur aktivitete dhe projekte edukative, kulturore dhe sportive ka vazhduar edhe këtë vit. Ne kemi vazhduar përkrahjen për projektin "ATOMI", projekti këtë vit shënon ciklin e tretë. Banka qysh nga viti i parë është përkrahësi i "ATOMIT" i cili ka për qëllim identifikimin e nxënësve me inteligjencë të lartë, krijimin e mundësive për mësim specifik, mundësive për të zhvilluar talentet e tyre. Poashtu në muajin prill janë mbajtur aktivitete që përkrahën tradicionalisht nga

banka Raiffeisen, Chopin Piano Fest dhe PriFest. Chopin Piano Fest dhe PriFest promovojnë kulturën e muzikës klasike dhe asaj filmike. Chopin Piano Fest shënoi edicionin e tij të pestë kurse PriFest edicionin e gjashtë. Këto dy projekte ofruan një program mjaft të pasur artistik. Më 24 maj 2014, banka Raiffeisen iu bashkua iniciativës "Ta pastrojmë Kosovën". Vullnetarë nga banka pastruan një hapësirë në Prishtinë për të treguar përkushtimin tonë për ambientin.

## ProCredit Bank pjesë e aksionit “Ta Pastrojmë Kosovën”



ProCredit Bank ka pranuar me entuziazëm ftesën e iniciativës qytetare ‘Ta Pastrojmë Kosovën’, duke pastruar hapësira publike në të gjitha qytetet e Kosovës ku operon banka. Mbi 250 staf të bankës kanë mbushur disa qindra qese me mbeturina duke dhënë mesazhin që një ambient i pastër është përgjegjësi e gjithë secilit.

ProCredit Bank mbështet fuqishëm idenë e kësaj iniciative se hedhja e mbeturinave në vendet e duhura dhe ruajtja e ambientit janë përgjegjësi e secilit prej nesh. Është vendi ynë, ta mbajmë pastër! 27 Maj 2014

## ProCredit Bank mbështet gjysmë maratonën ndërkombëtare të Prishtinës 2014

Me moton “Vrapo për paqe dhe tolerancë”, ProCredit Bank për të katërmbëdhjetin vit me radhë ishte mbështetëse e gjysmë maratonës, e cila nxori si triumfues Joel Maina nga Kenia në konkurrencën e meshkujve, kurse Ciran Elena Daniela triumfoi në konkurrencën e femrave. Ndërsa në konkurrencën e veteranëve, Zijadin Kryeziu arriti të dalë më i miri dhe ta rrëmbej sërish trofeun.

Më shumë se 1200 garues kanë marrë pjesë në gjysmë maratonën e këtij viti nga Kosova, Kenia, Maroku, Hungaria, Ukraina, Suedia, Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Bullgaria, Rumania, Moldavia e të tjera. ProCredit Bank që nga edicioni i parë i gjysmë maratonës të mbajtur më 2001, ka



mbështetur dhe përkrahur maratonën e Prishtinës, duke e vlerësuar si ngjarjen më të madhe sportive që organizohet në Kosovë. 12 Maj 2014



CERTIFIKIMI I PËRGJITHSHËM NDËRKOMBËTAR BANKAR

# BAZAT E AFARIZMIT BANKAR | EFCB

European Foundation Certificate in Banking



**FITONI NJOHURI DHE  
CERTIFIKATË BANKARE**

**KRIJONI VETES PËRPARËSI  
GJATË REKRUTIMIT NË BANKA**

**PËRFITONI NGA CERTIFIKATA E  
NJOHUR NDËRKOMBËTARISHT**

Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit, kontaktoni Qendrën për trajnim Bankare në Shoqatën e Bankave të Kosovës:

038 246 171  
kbatraining@bankassoc-kos.com  
www.bankassoc-kos.com



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

THE KOSOVO BANKER  
MBËSHETETET NGA  
FONDI EVROPIAN PËR  
EVROPËN JUGLINDORE

